

The background of the cover is a photograph of a child's room. On a light blue wall, several children's drawings are pinned. There is a drawing of a sun in the top left, a drawing of a person in the top center, a drawing of a landscape with a red triangle in the middle, and a drawing of a person with a red triangle in the bottom center. A red triangle is also pinned to the wall. In the foreground, there is a blue round table and two red chairs. A white light switch is visible on the wall.

PLANPROGRAMI I EDUKIMIT TË FËMIJËS

NË BAZË TË KURANIT FISNIK

Muhamed Ibrahim Selim

PLANPROGRAMI I EDUKIMIT TË FËMIJËS NË BAZË TË KUR'ANIT FISNIK

EDUKIMI I FËMIJËVE NË BAZË TË AJETEVE TË KUR'ANIT FISNIK

Autori:
Muhamed Ibrahim Selim

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Planprogrami i edukimit të fëmijës në bazë të Kur'anit fisnik

Korrektura:
Burim Bunjaku

Botues:
Përkthyesi

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

DHURATË

Për shokët e mi dijetarë dhe dijetare të bankave shkollore dhe punonjësit edukativo-arsimor, të cilët më kanë dhënë vullnet dhe shpresë për të përpiluar “Planprogram të plotë edukativ”, të cilët studiojnë dhe e mësojnë me nxënësit dhe studentët e tyre dhe punojnë në realizimin e parimeve me fjalë, vepër dhe sjellje.

Për djemtë dhe vajzat (nxënësit dhe nxënëset) e mia me të cilët jam konsultuar në klasë, ku kam qenë profesor i tyre dhe drejtor i edukimit dhe arsimimit, pranë fytyrave të cilëve kam lexuar pastërtinë e natyrshmërisë, bukurinë dhe lumturinë, në sytë e të cilëve kam parë kënaqësinë në All-llahun.

Për baballarët me të cilët jam takuar shpesh në punë, me të cilët kemi menduar dhe kemi hulumtuar rreth formimit të mendjes së shëndoshë, formimin e personalitetit, rrënjosjen e karakterit dhe ngritjen e vlerave dhe shpërndarjen e traditave fisnike.

Për çdo të interesuar për përgatitjen e gjeneratave të suksesshme, të lira, fisnike. Ja pra, libri për të gjithë ju “Planprogrami i edukimit të fëmijës musliman në bazë të parimeve të Kur’anit fisnik”. Më e mira që mund t’iu them juve është fjala e All-llahut të Lartëmadhëruar kur i thotë pejgamberit të Tij Jahja a.s.:

يَا يَحْيَىٰ خُذِ الْكِتَابَ بِقُوَّةٍ

“O Jahja merre librin me forcë dhe vendosmëri”

(Suretu Merjem 12).

Ejani pra dhe mësojeni planprogramin...

لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شُرْعَةً وَمِنْهَا جَا

“Për çdo njërin prej juve kemi përpiluar (bërë) ligj dhe planprogram”

(El-Maide 48).

All-llahu qoftë i kënaqur me ju dhe ua përmirësoftë gjendjen.

Muhamed Ibrahim Selim

UDHËZIMI I ALL-LLAHUT

قَالَ اهْبِطَا مِنْهَا جَمِيعًا ۖ بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ ۖ فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى فَمَنِ اتَّبَعَ هُدَايَ
فَلَا يَضِلُّ وَلَا يَشْقَى * وَمَنْ أَعْرَضَ عَن ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَعْمًى
* قَالَ رَبِّ لِمَ حَشَرْتَنِي أَعْمًى وَقَدْ كُنْتُ بَصِيرًا * قَالَ كَذَلِكَ أَتَتْكَ آيَاتُنَا فَنَسِيتَهَا ۖ وَكَذَلِكَ
الْيَوْمَ تُنْسَى

“Dhe kur nga unë ju vjen juve udhëzimi, kush vepron sipas udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në këtë botë) e as nuk ka për të dështuar. E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë, e në Ditën e Kijametit do ta ringjallim të verbër. E ai (i verbëti) do të thotë: Zoti im, pse më ngjalle të verbër, përderisa unë shihja me sy. Zoti i thotë: Ashtu siç ti i harrove argumentet Tona që t'i ofruam ashtu je i harruar sot”

TAHA : 123-126

Falënderojmë All-llahun.

Atë e falënderojmë, prej Tij ndihmë dhe përkrahje kërkujmë dhe prej tij falje për gabimet tona kërkujmë. Te ai kërkujmë mbrojtje prej të këqijave të vetes sonë dhe të këqijave të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu, s'ka për të devijuar. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut, i Cili është Një i Vetëm dhe nuk ka ortakë. Dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij.

Dhe...

Ja ku e kemi pranë librin Planprogrami i edukimit të fëmijës musliman siç e parasheh Kur'ani fisnik, e cila na orienton në atë çka është e mirë dhe e dobishme për shoqërinë tonë dhe na i organizon neve marrëdhëniet me veten tonë dhe me shoqërinë konform Kur'anit fisnik. Nga ky prizëm para neve paraqet sjelljet e mira me të cilat duhet të mësohemi dhe sjelljet e këqija prej të cilave duhet të largohemi. Po ashtu na mëson që të bëhemi prej atyre të cilët All-llahu i do dhe të veprojmë që të arrijmë dashurinë dhe kënaqësinë e Tij.

Libri nuk përfundon derisa nuk ju paraqet shembuj të atyre të cilët arrijnë lumturinë duke i përgëzuar All-llahu me xhenet dhe të atyre të cilët janë pabesimtarë, për të cilët nuk ka përgëzim. Në fund paraqitet besimtari me fytyrë të shkëlqyer, trup të fuqishëm, zemër të devotshme dhe mendje të shëndoshë.

Kemi paraqitur parimin e karakterit dhe moralit, të cilin e kemi marrë prej ajeteve kur'anore, pastaj kemi paraqitur saktësisht ajetin pranë tij (arabisht dhe shqip), numrin e ajetit, emrin Sures, me qëllim që të mësohet përmendësh dhe për të treguar burimin bazë të pastër dhe të ëmbël. Nuk jemi ndalur në këtë pikë, por i kemi përmbledhur "parimet e karakterit dhe moralit" të rezultuara prej ajeteve në kapitull të veçantë për të të përkujtuar çdo pjesë të ajetit. Po ashtu ajeti të jep orientimin në Kur'an, dhe për ju djem dhe vajza dëshirojmë dhe kemi shpresë që secili prej juve të jetë Kur'an i cili ecë në tokë nga aspekti i besimit, moralit dhe sjelljeve me të cilat duhet të vishemi të gjithë ne. Prindër dhe djem, profesorë e studentë, të gjithë të vishemi me këto parime të forta të moralit, që Edukata Kur'anore të bëhet simbol i çdo muslimani dhe kështu nga thellësia e ndërtesës Islame të ngrihet Islami i cili po shkatërrohet dhe në brendësi tona të ngjallet njeriu i cili po shkelet.

Dhe lutja jonë e fundit: Falënderojmë All-llahun, Zotin e të gjithë botëve!

FORMIMI I KARAKTERIT NJERËZOR

-E PARA-

**Parimet themelore të Kur'anit të cilat organizojnë marrëdhëniet e
njeriut me veten e tij**

1 Mendo në veten tënde, mendo në veten si je krijuar? Prej çka je krijuar? Ai i cili e njeh (kupton) veten e tij, ai e njeh Zotin dhe Krijuesin e tij.

أَوَلَمْ يَتَفَكَّرُوا فِي أَنْفُسِهِمْ ۚ مَا خَلَقَ اللَّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَأَجَلٍ مُّسَمًّى ۚ وَإِنَّ كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ بِلِقَاءِ رَبِّهِمْ لَكَافِرُونَ

“A nuk po mendojnë në veten e tyre (si janë krijuar)?”

Err-Rum 8

فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ

“Le të shikoj (vështrojë) njeriu prej çka është Krijuar”

El-Tarik 5

2 Shiko në veten tënde dhe përsosi vlerat tua. Zhvillimi i shoqërisë fillon prej zhvillimit të individit.

أَتَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبِرِّ وَتَنْسَوْنَ أَنْفُسَكُمْ وَأَنْتُمْ تَتْلُونَ الْكِتَابَ ۚ أَفَلَا تَعْقِلُونَ

“E si i urdhëroni njerëzit për të punuar punë të mira, e (në të njëjtën kohë) e harroni veten tuaj”

El-Bekare 44

3 Atëherë kur njeriu e përsos moralin dhe karakterin e tij, atëherë nuk mund t'i bën dëm askush.

... عَلَيْكُمْ أَنْفُسَكُمْ ۚ لَا يَضُرُّكُمْ مِّنْ ضَلٍّ إِذَا اهْتَدَيْتُمْ ۚ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

“...ruajeni dhe përsoseni veten tuaj, nuk mund të ju dëmtoj ai i cili ka humbur pasi që ju veç jeni të udhëzuar”

El-Maide 105

4 Shpëtimtar dhe fitimtar është ai i cili e pastron veten e tij dhe i përulet vetëm Zotit të tij. I dështuar dhe i humbur është ai i cili e njollos veten e tij me mëkate.

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا * وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا

“Veç ka shpëtuar ai i cili e ka pastruar veten e tij ndërsa ka dështuar ai i cili e ka njollosur veten e tij me mëkate”

Esh-Shems 9,10

5 Në trup ka epshe dhe pasione, mos iu nënshtro epsheve dhe pasioneve në mëkate sepse epshi urdhëron në të keqe.

وَمَا أُبْرِيْ نَفْسِيْ ۚ إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي ۚ إِنَّ رَبِّي غَفُورٌ رَّحِيمٌ

“Dhe, unë nuk e arsyetoj më veten time, se vërtetë epshi urdhëron në të këqija”

Jusuf 53

6 Ti je përgjegjës para All-llahut për lëvizjet e tua, dhe dije se do të jesh përgjegjës për çdo gjë (qofshin edhe më të imtat).

...كُلُّ امْرِيٍّ بِمَا كَسَبَ رَهِيْنٌ

“Secili njeri është peng i asaj që ka punuar”

Et-Tur 21

7 Çka të veprosh për atë do të paguhesh (shpërblehesh).

إِنْ أَحْسَنْتُمْ أَحْسَنْتُمْ لِأَنْفُسِكُمْ ۖ وَإِنْ أَسَأْتُمْ فَلَهَا...

“Nëse bëni mirë ju, keni bërë mirë për veten tuaj, e nëse bëni keq do të dënoheni për të”

El-Isra 7

8| Trupi yt është amanet në duart tua, për këtë arsye ti je përgjegjës për mbrojtjen e tij nga zjarri.

...قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ...

“Mbroni veten dhe familjen tuaj nga zjarri, ku lëndë djegëse janë njerëzit dhe gurët”

Et-Tehrimë 6

9| Edukoje veten që të duroj se durimi është gjysma e imanit.

...وَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا أَصَابَكَ ۖ إِنَّ ذَٰلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ

“Dhe, duro për atë çka të ka goditur sepse kjo është prej çështjeve thelbësore”

El-Lukman 17

10| Për çdo çështje, para se ta qortosh shejtanin qortoje veten tënde.

... فَلَا تَلُمُونِي وَلُومُوا أَنْفُسَكُمْ ...

“Dhe mos më qortoni mua, por qortoni veten tuaj”

Ibrahim 22

11| Gjithmonë siguroje veten tënde dhe kërko mbrojtje prej Zotit nga e keqja e cytësit të vesveseve.

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ * مَلِكِ النَّاسِ * إِلَهِ النَّاسِ *

مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ

“Thuaj: Kërkoj mbrojtje nga Zoti i njerëzve, sundimtarit të njerëzve, Zotit të njerëzve nga e keqja e cytësit të vesveseve”

En-Nas 1-4

12| Largohu nga shokët e këqij që të mos humbasësh nga rruga e drejtë pasi që je udhëzuar.

يَا وَيْلَتَى لَيْتَنِي لَمْ أَتَّخِذْ فُلَانًا خَلِيلًا *
لَقَدْ أَضَلَّنِي عَنِ الذِّكْرِ بَعْدَ إِذْ جَاءَنِي ۚ وَكَانَ الشَّيْطَانُ لِلْإِنْسَانِ خَذُولًا

“Mjerë, mjerë për mua! A sikur mos ta kisha marrë për shok filanin. Ai më humbi mua nga besimi (imani) pasi që ishte vulosur në mua”

Suretul Furkan 28-29

13| Metodologjia e jote le të jetë *fjala e mirë*.

أَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ
وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ

“A nuk e ke parë se si All-llahu e ka sjellë shembull fjalën e mirë si një pemë e mirë e cila i ka rrënjët thellë dhe të forta ndërsa degët e saj lartë në qiell”

Ibrahim 24

14| Mësoje veten të jesh mesatar, ruaju nga teprimi dhe shkapërderdhja.

إِنَّ الْمُبَدِّرِينَ كَانُوا إِخْوَانَ الشَّيَاطِينِ ۚ وَكَانَ الشَّيْطَانُ لِرَبِّهِ كَفُورًا

“Vërtetë tepruesit dhe shkatërrimtarët janë vëllezër të shejtanit”

El-Isra 28

15 Bëhu i sinqertë, se rrenacakët nuk kanë shpëtim.

قُلْ إِنَّ الَّذِينَ يَفْتُرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ لَا يُفْلِحُونَ

“Thuaj: Vërtetë ata të cilët shpifin për All-llahun rrena, nuk shpëtojnë”

Junus 69

16 Fol mirë dhe vepro mirë ashtu siç All-llahu të ka bërë mirë.

...وَأَحْسِنَ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ...

“Dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu mirë”

El Kasas 77

هَلْ جَزَاءُ الْإِحْسَانِ إِلَّا الْإِحْسَانُ

“Shpërblimi për të mirë nuk është asgjë tjetër pos shpërblim mirësie” Err-Rrahman 60

17 Ruaje dëgjimin tënd dhe shikimin tënd nga e keqja se All-llahu ka mundësi të ta merr (dëgjimin dhe shikimin).

...وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَذَهَبَ بِسَمْعِهِمْ وَأَبْصَارِهِمْ...

“Po të donte All-llahu do t’u merrte dëgjimin e tyre dhe shikimin e tyre, vërtetë All-llahu ka mundësi për çdo send”

El-Bekare 20

18] Shfrytëzoje mendjen tënde dhe aftësitë tua me të cilat All-llahu të ka graduar, e mos i paralizo.

وَلَقَدْ ذَرَأْنَا لِجَهَنَّمَ كَثِيرًا مِّنَ الْجِنِّ وَالْإِنسِ ۖ لَهُمْ قُلُوبٌ لَا يَفْقَهُونَ بِهَا وَهُمْ أَعْيُنٌ لَا يُبْصِرُونَ
بِهَا وَهُمْ آذَانٌ لَا يَسْمَعُونَ بِهَا ۖ أُولَٰئِكَ كَالْأَنْعَامِ بَلْ هُمْ أَضَلُّ ۖ
أُولَٰئِكَ هُمُ الْعَافِلُونَ

**“Ata kanë zemra (mendje) por nuk (dëshirojnë) kuptojnë me to,
ata kanë sy por nuk shohin me ato sy, ata kanë vesh por nuk
dëgjojnë me ato veshë, ato janë sikurse kafshët por edhe më të
humbur, ata janë indiferent”**

El-Earaf 179

19] Në rrugë të All-llahut thirr me mençuri dhe polemizo në atë çka është më e mira.

ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ ۖ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ ۚ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ
أَعْلَمُ بِمَن ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ ۖ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ

**“Në rrugën e Zotit tënd thirr me mençuri dhe me këshillat më të
mira dhe më të përshtatshme dhe po ashtu polemizo në atë çka
është më e mira dhe më e dobishmja”**

En-Nahl 125

20] Përfito aftësi në vete ashtu që të jesh në gjendje ta kuptosh dhe ta dallosh të mirën prej të keqes.

قُلْ لَا يَسْتَوِي الْخَبِيثُ وَالطَّيِّبُ وَلَوْ أَعْجَبَكَ كَثْرَةُ الْخَبِيثِ ۚ فَاتَّقُوا اللَّهَ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ
لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

**“Thuaj: Nuk janë të barabarta e mira me të keqen edhe nëse të
mahnitin të shumtat e të këqijave”**

El-Maide 100

21 Ruaju lakmisë në vetvete, koprracisë, përtacisë, armiqve të Allahut dhe njerëzve.

...وَمَنْ يُوقِ شُحَّ نَفْسِهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Dhe kush e ruan veten nga lakmia, të tillët janë ata që janë të shpëtuar”

El Hashr 9

22 Mbizotëroje mendjen tënde dhe mos u bëj rob i epsheve dhe emocioneve tua.

... وَعَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ ۖ وَعَسَىٰ أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ شَرٌّ لَّكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ndoshta e urreni ndonjë send por ai (send) përkundrazi është i dobishëm për ju, e ndoshta e doni ndonjë send e ai (send) përkundrazi është i dëmshëm për ju”

El-Bekare 216

23 Mos lejo që të mashtrohesh e tradhtohesh, andaj çdo lajm vërtetoje dhe asnjëherë mos thuaj se e kam parë për një send që se ke parë, ose të thuash kam dëgjuar atë çka nuk e ke dëgjuar, sepse All-llahu do të të merr në përgjegjësi për këtë.

وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ ۚ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَٰئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا

“Dhe mos trego për diçka për të cilën nuk ke njohuri se padyshim për dëgjimin, shikimin, mendjen, për të gjitha këto do të japësh llogari”

El Isra 36

24| Mos dëshiro të kesh gjithçka që kanë njerëzit, do të jesh më i pasuri i tyre. Pasuri e vërtetë është pasuria e shpirtit.

... يَحْسَبُهُمُ الْجَاهِلُ أَغْنِيَاءَ مِنَ التَّعَفُّفِ تَعْرِفُهُمْ بِسِيمَاهُمْ لَا يَسْأَلُونَ النَّاسَ إِلْحَافًا ۚ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ خَيْرٍ

“I huaji mendon se janë të pasur duke parë modestinë (dhe mos lypjen e tyre), ata mund t’i kuptosh vetëm nëpërmjet shenjave në ta, ndërsa ata nuk kërkojnë prej njerëzve ndonjë nevojë”

El-Bekare 273

25| Ta dish, besnikët janë shumë të fuqishëm, e ti fuqinë tënde kërkoje në besnikëri.

... إِنَّ خَيْرَ مَنْ اسْتَأْجَرْتَ الْقَوِيُّ الْأَمِينُ

“Vërtetë atë të cilin duhet ta shpërblesh është i fuqishëm dhe besnik”

El-Kasas 26

26| Kërko ndihmë dhe mbështetje prej All-llahut sepse All-llahu është i mëshirshëm dhe i përkrah ata që kërkojnë ndihmë prej tij.

قَالَ رَبِّ احْكُم بِالْحَقِّ ۚ وَرَبُّنَا الرَّحْمَنُ الْمُسْتَعَانُ عَلَىٰ مَا تَصِفُونَ

“Tha: Zoti im! Gjyko me drejtësi. Sepse Zoti ynë është bamirës dhe i përkrah ata që kërkojnë ndihmë”

El-Enbija 112

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

“Dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë”

El-Fatiha 5

27] Bëhu me të dëgjueshmit dhe ata të cilët veprojnë dhe e pasojnë të mirën, atëherë All-llahu do të udhëzojë.

الَّذِينَ يَسْمِعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ ۚ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ هَدَاهُمُ اللَّهُ ۖ
وَأُولَٰئِكَ هُمُ أُولُو الْأَلْبَابِ

“Ata të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë të mirën, ata janë të cilët i ka udhëzuar All-llahu, dhe ata janë të mençurit”

Ez-Zumer 18

28] Kujtoje All-llahun i cili të ka udhëzuar në Islam, ta ka ndriçuar rrugën e drejtë dhe ta ka mbushur zemrën me dashuri ndaj All-llahut.

أَفَمَنْ شَرَحَ اللَّهُ صَدْرَهُ لِلْإِسْلَامِ فَهُوَ عَلَىٰ نُورٍ مِّن رَّبِّهِ ۚ فَوَيْلٌ لِلْقَاسِيَةِ قُلُوبُهُم مِّن ذِكْرِ
اللَّهِ ۚ أُولَٰئِكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ

“Apo, atij të cilit All-llahu ia ka zgjeruar kraharorin e tij në Islam, e vërtetë ai është dritë e Zotit të Tij. E mjerë për ata të cilët zemrat e tyre i kanë të ashpra dhe të pazbutura me kujtimin e All-llahut. Ata janë në humbje të qartë dhe të sigurt”

Ez-Zumer 22

29] Përqendrohu dhe përmbaju në atë çka të ka urdhëruar All-llahu, sepse pas imanit vjen përmbajtja dhe përqendrimi (qënd-rueshmëria).

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Vërtetë ata të cilët thonë All-llahu është Zoti ynë, e pastaj përqendrohen në fenë e tyre, për ata nuk ka as frikë, as brengosje e as pikëllim”

El-Ehkaf 13

30 Në çdo mbrëmje llogariti veprat tua, para se të të llogariten (para se të vdesësh).

يَوْمَئِذٍ تُعْرَضُونَ لَا تَخْفَى مِنْكُمْ خَافِيَةٌ * فَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ يَمِينَهُ فَيَقُولُ هَؤُلَاءِ أَقْرَأُوا كِتَابِيَّةً
* إِنِّي ظَنَنْتُ أَنِّي مُلَاقٍ حِسَابِيَّةً

**“Atë ditë kur do të paraqiten, dhe askujt nuk mund t’i fshihet asgjë.
Dhe atij të cilit libri i jepet në dorë të djathtë thotë: Gjeni dhe
lexoni librin tim. Vërtet unë kam menduar se do të jap llogari të
vështirë”**

El-Haka 18-20

31 Ruaju e mos e dëmto dhe mos e shkatërro veten me duart tua.

وَأَنْفِقُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ ۚ وَأَحْسِنُوا ۚ
إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

“Mos e shpini veten në shkatërrim me duart tuaja”

El-Bekare 195

... وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا

**“Dhe mos e mbytni veten tuaj. Vërtet All-llahu është i Mëshirshëm
për ju”**

En-Nisa 29

32 Mos bëj gabime sepse gabimi të sjellë nënçmim dhe turpërim
ndërsa besimtari gjithmonë është bujar, fisnik, i çmuar dhe i fuqishëm.

هَذَا يَوْمٌ لَا يَنْطِقُونَ * وَلَا يُؤْذَنُ لَهُمْ فَيَعْتَذِرُونَ

**“Kjo është dita ku askush nuk flet dhe askujt nuk i lejohej të
arsyetohet për fajësinë e tij”**

El-Murselat 35, 36

33] Mos u bëj egoist, mos lakmo të kesh vetëm për vete. Natyrshmëri e muslimanit është që veten e le keq për t'u bë mirë tjerëve.

وَلَا يَجِدُونَ فِي صُدُورِهِمْ حَاجَةً مِّمَّا أُوتُوا وَيُؤْثِرُونَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ

“Dhe vetmohohen edhe pse kanë nevojë për ato çështje”

El-Hashr 9

34] Nëse mizëron veten (i bën padrejtësi vetes) kërko falje te All-llahu.

قَالَ رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي فَغَفَرَ لَهُ ۚ إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

“O Zoti im - tha: Vërtet unë i bëra padrejtësi vetes, andaj më fal mua, dhe e fali atë”.

El Kasas 16

35] Mos e tepro, dhe mos e ngarko veten më shumë se sa ke mundësi. Dera e shpresës gjithmonë është e hapur.

قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِنْ رَحْمَةِ اللَّهِ ۚ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا ۚ إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

“Thuaj: O robërit e mi të cilët e keni tejkaluar në gabime kundër vetes suaj, mos e humbni shpresën në mëshirën e All-llahut. Vërtet All-llahu është Falës, Mëshirues”

Ez-Zumer 53

36] Ke kujdes mos fsheh në vete çështje të cilat sjellin hidhërimin e All-llahut ndaj teje.

وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي أَنْفُسِكُمْ فَاحْذَرُوهُ

“Dhe dijeni se All-llahu din çka ka në veten tuaj dhe keni kujdes”

El-Bekare 235

37| Maturia është koka e ilaçit ndërsa teprimi është sëmundje.

وَكُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا تُسْرِفُوا ۚ

“Dhe hani e pini por (kurrë) mos e teproni”

El-Earaf 31

38| Shejtani është armik i të gjitha kohërave, mos i paso hapat e tij, por bëhu armik i tij.

وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ ۚ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ

“Mos i pasoni hapat e shejtanit, se vërtetë ai është armik i hapët”

El-Bekare 168

إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمْ عَدُوٌّ فَاتَّخِذُوهُ عَدُوًّا

“Vërtetë, shejtani është armik i juaji, dhe (gjithmonë) ju merreni për armik tuajin”

Fatir 6

39| Mos e ngarko veten me atë çka nuk ke mundësi por me atë çka ke mundësi.

... لَا تُكَلِّفُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا ...

“Dhe mos e ngarko veten ndryshe por vetëm aq sa ke mundësi”

El-Bekare 233

40] Fitimi dhe vdekja janë vetëm në diturinë e All-llahut.

...وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ مَّاذَا تَكْسِبُ غَدًا ۖ وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ بِأَيِّ أَرْضٍ تَمُوتُ ۚ
إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ

**“Asnjë njeri nuk din çka fiton, çka i ndodh nesër, dhe asnjë njeri
nuk di se në cilin vend të tokës do të vdesë”**

Lukman 34

41] All-llahu na sprovon neve me të mira ashtu siç sprovon me të këqija.

وَنَبْلُوكُم بِالشَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةً ۚ وَإِلَيْنَا تُرْجَعُونَ

**“Dhe ju sprovovmë juve me të këqija dhe të mira, sprovim i aftësive
dhe gjendjes tuaj”**

El-Enbija 35

42] Kush i frikësohet All-llahut dhe e ndalon veten nga epshet, vendbanim e ka xhenetin.

وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَنَهَى النَّفْسَ عَنِ الْهَوَىٰ *
فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَىٰ

**“Dhe për atë i cili i frikësohet Zotit të vet dhe e ndalon veten nga
epshet. Vërtet xheneti është vendbanim për të.”**

En-Naziat 40

43] Ai që i kalon kufijtë të cilat i ka caktuar All-llahu ai i ka bërë padrejtësi vetes së vet.

... وَمَنْ يَتَعَدَّ حُدُودَ اللَّهِ فَقَدْ ظَلَمَ نَفْسَهُ ...

**“Dhe kush i tejkalon kufijtë e All-llahut, ai veç i ka bërë padrejtësi
vetes së vet”**

Talak 1

RAPORTET ME KRIJUESIN

-E DYTA-

**Bazat dhe parimet Kur'anore të cilat i rregullojnë marrëdhëniet e
besimtarit me Krijuesin**

1 Që nga fillimi përforcoje besimin në Zotin, shpejto pa masë në fitimin e kënaqësisë së Tij dhe mos lejo që diçka tjetër të të largoj nga Ai.

فَفِرُّوا إِلَى اللَّهِ ۖ إِنِّي لَكُم مِّنْهُ نَذِيرٌ مُّبِينٌ

“Dhe shpejtoni (në fitimin e kënaqësisë) në All-llahun, vërtetë Unë për ju jam këshilltari (për punë të mira) më i hapur”

Edh-Dharijat 50

2 Lutju vetëm Atij e askujt tjetër. Ai është i cili i ka krijuar qiejt dhe tokën.

إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا ۖ وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ

“Vërtet unë ktheva fytyrën time në drejtim të Atij që ka krijuar qiejt dhe tokën pa asnjë njollë, të pastër, dhe unë kurrësi nuk jam prej idhujtarëve”

El-En'am 79

3 Ji me Atë, do të jetë me ty, sepse kush është me All-llahun, All-llahu është me të, e ruan dhe e mbron.

قَالَ لَا تَخَافَا ۖ إِنَّنِي مَعَكُمَا أَسْمِعُ وَأَرَىٰ

“Mos u frikësoni, vërtet unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh”

TAHA 46

4 Kujtoje All-llahun, Ai të kujton ty.

فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ وَاشْكُرُوا لِي وَلَا تَكْفُرُونِ

“Kujtomëni Mua, ju kujtoj juve”

El-Bekare 152

51 Kërko falje prej Tij, Ai të falë.

وَمَنْ يَعْمَلْ سُوءًا أَوْ يَظْلِمْ نَفْسَهُ ثُمَّ يَسْتَغْفِرِ اللَّهَ يَجِدِ اللَّهَ غَفُورًا رَحِيمًا

“Dhe kush vepron ndonjë të keqe, ose bën padrejtësi vetes së tij, pastaj pendohet dhe kërkon falje prej All-llahut, All-llahu e falë, se Ai është Falës dhe Mëshirues”

Nisa 110

61 Falënderoje Atë për të mirat që t'i ka dhënë, haptazi e fshehtazi, me fjalë e me vepra, All-llahu do t'i shtoj të mirat e Tij.

...لَيْنِ شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ...

“Nëse ju falënderoni, Ai ju shton të mirat”

Ibrahim 7

71 Lutu, do të pranohet lutja.

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ ۖ
أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ ۖ فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي

“Dhe nëse të pyesin robërit e mi për Mua, Unë jam afër, padyshim e pranoj lutjen e lutësit kur më lutet”

El-Bekare 187

81 Pendohu do të pranohet pendimi.

وَإِنِّي لَغَفَّارٌ لِّمَن تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا ثُمَّ اهْتَدَىٰ

“Vërtetë Unë jam falës për atë i cili pendohet, beson dhe vepron punë të mira e po ashtu udhëzohet në rrugë të drejtë”

TA-HA 82

9| Adhuro vetëm All-llahun e askënd tjetër, ndërsa ndaj prindërve sillu mirë.

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا...

“Zoti yt të ka caktuar që të mos adhurosh askënd tjetër pos Tij dhe që të sillesh mirë ndaj prindërve”

El-Isra 23

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

“Vetëm Ty të adhurojmë”

El-Fatiha 5

10| Kërko prej All-llahut udhëzim dhe pajtim në veprimet tua, Ai do të udhëzoj.

اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ *

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

“Na udhëzo në rrugën e drejtë (stabile dhe të qëndrueshme) në rrugën e atyre të cilëve u ke dhënë (dhe u jep) të gjitha të mirat, e assesi në rrugën e atyre të cilët fitojnë hidhërimin Tënd, e as të atyre të cilët janë të humbur”

El-Fatiha 6-7

11| Kërko nga All-llahu i Lartëmadhëruar që Ai ta dojë imanin në ty, ta zbukuroj dhe ta përforcoj në zemrën tënde.

...وَلَكِنَّ اللَّهَ حَبَّبَ إِلَيْكُمُ الْإِيمَانَ وَزَيَّنَهُ فِي قُلُوبِكُمْ...

“Mirëpo All-llahu e donë imanin e fortë në ju, dhe do që ta stolis dhe përforcoj në zemrat tua”

El-Huxhurat 7

12 Mbështetju All-llahut, të mjafton për gjithçka.

...وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ...

“Dhe kush i mbështet All-llahut, Ai (atij) i mjafton (për gjithçka)”

Et-Talak 3

وَتَوَكَّلْ عَلَى الْحَيِّ الَّذِي لَا يَمُوتُ...

“Dhe mbështetu Atij i cili është i Gjallë dhe nuk vdes kurrë”

El-Furkan 58

13 Ta dish, All-llahu nuk është indiferent ndaj veprimeve tua, andaj ta dish se të përcjell pandërprerë ditë e natë.

...وَمَا اللَّهُ بِعَافٍ لِّمَا تَعْمَلُونَ

“All-llahu nuk është indiferent nga ajo që veproni”

El-Bekare 74

14 Frikësoju All-llahut, vepro çka të ka udhëzuar dhe largohu prej asaj çka ta ka ndaluar, atëherë Ai do të mësoj.

وَإِيَّايَ فَاتَّقُونِ

“Dhe Mua frikësomuni”

El-Bekare 41

وَاتَّقُوا اللَّهَ ۖ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ

“Dhe, frikësojuni All-llahut, All-llahu do t’iu mësoj”

El-Bekare 282

15] Kush i frikësohet All-llahut, ai e nxjerr nga kurthet dhe ia zgjeron furnizimin.

وَيَرْزُقُهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ ۚ وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ ۚ إِنَّ اللَّهَ بَالِغُ أَمْرِهِ ۚ قَدْ جَعَلَ اللَّهُ لِكُلِّ شَيْءٍ قَدْرًا

“Dhe kush i frikësohet All-llahut, (All-llahu) i gjen rrugëdalje (dhe zgjidhje të çështjeve) dhe e furnizon atë nga aty që nuk e llogarit fare”

Et-Talak 3

16] Veçoje dhe lartësoje All-llahun dhe lavdëroje shpesh dhe pandërprerë ashtu siç e meriton.

...فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ

“Dhe, Lartësimi i takon vetëm All-llahut, Krijuesit më të mirë”

El-Muëminunë 14

تَبَارَكَ الَّذِي بِيَدِهِ الْمُلْكُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Lartësimi i takon All-llahut, në dorë të Tij është sundimi, dhe ai ka mundësi mbi çdo send dhe për çdo send”

El-Mulk 1

...أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ ۚ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

“Pra, Atij i takon krijimi dhe i takon çdo çështje. Lartësimi i takon vetëm Zotit të gjithë botëve”

El-Earaf 54

تَبَارَكَ الَّذِي جَعَلَ فِي السَّمَاءِ بُرُوجًا وَجَعَلَ فِيهَا سِرَاجًا وَقَمَرًا مُنِيرًا

“Lartësimi i takon Atij që ka krijuar në qiej yje, dhe në qiej ka krijuar planetë dhe ka krijuar hënën e ndriçuar”

El-Furkan 61

تَبَارَكَ اسْمُ رَبِّكَ ذِي الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

“Lartësimi i takon vetëm emrit të Zotit tënd të Lartëmadhëruar”

Err-Rahman 78

171 Mos i dëgjo mëkatarët e as mos i përkrah të padrejtit.

وَلَا تُطِيعْ مَنْ أَغْفَلْنَا قَلْبَهُ عَنْ ذِكْرِنَا وَاتَّبَعَ هَوَاهُ

**“Mos dëgjo atë që e ka mbyll zemrën nga libri ynë dhe ka pasuar
epshet e tij”**

Kehf 28

وَلَا تُطِيعْ كُلَّ حَلَّافٍ مِّمَّهِينَ

“Mos e respekto askënd që betohet shumë dhe është i poshtër!”

Kalem 10

...وَلَا تُطِيعِ الْكَافِرِينَ وَالْمُنَافِقِينَ

“Mos dëgjo pabesimtarët dhe hipokritët”

El-Ahzab 1

وَلَا تَرْكَبُوا إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا فَتَمَسَّكُمُ النَّارُ *

وَمَا لَكُمْ مِّنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ أَوْلِيَاءَ ثُمَّ لَا تُنصَرُونَ

**“Dhe mos u bazoni e të mbështeteni te ata të cilët kanë bërë krim,
se pastaj ju kaplon zjarri”**

Hud 113

وَلَا تُطِيعُوا أَمْرَ الْمُسْرِفِينَ

“Dhe mos dëgjoni çështjet prej shkapërderdhësve”

Shuaraë 151

18 Jeta jote, veprimtaria jote, vendi dhe koha janë çështje në dorë të All-llahut dhe në dëshirën e Tij, andaj para të veprosh një punë thuaj: “Inshaa Allah”.

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ...

“Dhe ata nuk dëshirojnë asgjë tjetër pos çka dëshiruar All-llahu”

El-Insan 30

وَلَا تَقُولَنَّ لِشَيْءٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَلِكَ عَبْدًا * إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ...

“Dhe mos thuaj asnjëherë për asgjë se vërtet unë do të bëjë këtë nesër pa thënë: Vetëm nëse dëshiron All-llahu”

El-Kehf 23-24

19 Vështirësitë dhe fatkeqësitë nuk mund t'i largoj prej teje askush përpos All-llahut, andaj drejtoju Atij.

وَإِذَا مَسَّكُمُ الضُّرُّ فِي الْبَحْرِ ضَلَّ مَنْ تَدْعُونَ إِلَّا إِلَاهُ

“Dhe kur ju kaplon frika, vështirësia, e fatkeqësia në det edhe i humburi e lutë vetëm Atë (All-llahun)”

El-Isra 67

بَلْ إِلَاهُهُ تَدْعُونَ فَيَكْشِفُ مَا تَدْعُونَ إِلَيْهِ إِنْ شَاءَ وَتَنْسَوْنَ مَا تُشْرِكُونَ

“Por vetëm atij i luteni, dhe ju largon fatkeqësitë dhe ju jep çka kërkon, nëse donë Ai”

El-Enam 41

20 Jeta jote le të jetë mes frikës (dënimit) dhe shpresës (shpërblimit), e po ashtu edhe garë në punë të mira.

أَلَمْ يَعْلَم بِأَنَّ اللَّهَ يَرَى

“A nuk e din se vërtet All-llahu sheh”

El-Alek 14

...وَأَيَّايَ فَارْهَبُونِ

“Dhe vetëm Mua më keni frikë”

El-Bekare 40

أَمْرٌ هُوَ فَاِنْتِ آتَاءَ اللَّيْلِ سَاجِدًا وَقَائِمًا يَحْذَرُ الْآخِرَةَ وَيَرْجُو رَحْمَةَ رَبِّهِ...

“Apo ai që kohën e natë e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimit të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet?”

Ez-Zumer 9

...إِنَّهُمْ كَانُوا يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا...

“Ata (pejgamberët) garonin në punë të mira dhe na luteshin Neve me frikë dhe shpresë”

El-Enbija 90

21 Shpresa në mëshirën e Zotit është punë e mirë.

...فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا...

“Dhe kush shpreson në takimin me Zotin e Tij le të veprojë punë të mira”

El-Kehf 110

22 Çdo të mirë që e punon do ta gjesht te All-llahu. Nëse jep sadaka Zoti ta shumëfishon.

إِنْ تُقْرِضُوا اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا يُمْضَاعِفْهُ لَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ...

“Nëse huazoni te All-llahu çdo lloj huazimi të mirë, atë do t’ua shtojë juve, dhe do t’u falë juve”

Et-Tegabun 17

وَمَا تُقَدِّمُوا لِأَنفُسِكُمْ مِّنْ خَيْرٍ يَّجِدُوهُ عِنْدَ اللَّهِ

“Dhe çdo të mirë që e përgatitni dhe e bëni për veten tuaj, atë (të mirë) do ta gjeni te All-llahu”

El-Bekare 110

23| Shtëpinë tënde stolise me kujtim në All-llahun, me falje të namazit dhe me qetësi për njerëzit.

...وَاجْعَلُوا بُيُوتَكُمْ قِبْلَةً...

“Dhe shtëpitë e juaja bëni kible (vendfalje)”

Junus 87

24| Mos u krekos me diturinë tënde sepse All-llahu është Ai i cili ta ka mësuar atë që nuk e ke ditur.

قَالُوا سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا ۚ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

“Lavdërimi dhe Madhërimi të takon Ty o Zot, ne nuk kemi dituri përpos atë çka na ke mësuar”

El-Bekare 32

25| Lutju Zotit që të ta shtoj diturinë në ty, të të bëj të dobishëm dhe të devotshëm.

وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

“Dhe thuaj: Zoti im shtona diturinë”

TAHA 114

26] Dituria është dritë e edhe besimi është dritë. Lutu që këto dy të mira të kompletohen në ty.

رَبَّنَا آتِنَا لَنَا نُورًا وَاعْفِرْ لَنَا

“O Zoti ynë plotëso dritën në ne dhe për ne”

Et-Tahrime 8

27] Nëse gabon ose harron menjëherë lutju Zotit që mos të të ndëshkoj.

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا

“O Zoti ynë mos na ndëshko nëse rastësisht harrojmë ose gabojmë”

El-Bekare 286

28] Falënderimi është shpirti i adhurimit, andaj falënderoje All-llahun vazhdimisht.

وَأَشْكُرُوا لِلَّهِ إِنْ كُنْتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ

“Dhe falënderoni All-llahun nëse atë dëshironi ta adhuroni me adhurim të vërtetë”

El-Bekare 172

29] Fol për të mirat dhe begatitë e All-llahut dhe insisto gjithmonë tek bashkëbiseduesit që të flasin për to, sepse All-llahu dëshiron që të shihen të mirat e Tij tek robërit e tij.

وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ

“Dhe për të mirat dhe begatitë e Zotit Tënd komuniko”

Ed-Duha 11

30| Allahut nuk i përngjanë asgjë dhe askush nuk është i barabartë me të.

لَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ

“Dhe nuk i ngjanë, Atij askush”

Ihlas 4

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ

“Si Ai nuk është asgjë dhe askush”

Shura 11

31| Nuk duhet që të betohemi në All-llahun pa nevojë, por duhet që All-llahun ta çmojmë ashtu siç e meriton të çmohet.

وَلَا تَجْعَلُوا اللَّهَ عُرْضَةً لِأَيْمَانِكُمْ أَنْ تَبَرُّوا وَتَتَّقُوا

“E mos e bëni All-llahun peng të betimeve tuaja, kur doni të bëni vepra të mira”

El-Bekare 224

32| Nuk duhet që t’i fyejmë idhujt e tjerëve sepse kjo ndikon që tjerët të fyejnë Zotin tonë.

وَلَا تَسُبُّوا الَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ فَيَسُبُّوا اللَّهَ عَدْوًا بِغَيْرِ عِلْمٍ

“Dhe mos i shani ata të cilët adhurohen përpos All-llahut se (adhuruesit) e shajnë All-llahun armiqësisht, pa pasur kurrfarë diturie”

El-En’am 108

33] Allahu është Ai i cili natën e bën ditë, për këtë arsye lutju Atij ditë e natë dhe merr këshillë dhe mësim prej saj.

يُقَلِّبُ اللَّهُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ ۚ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِّأُولِي الْأَبْصَارِ

“All-llahu natën e shndërron në ditë. Vërtetë në këtë ka argumente për të logjikshmit dhe vizionarët”

En-Nurë 44

34] Feja e All-llahut ka rregulla dhe kufij dhe këto kufij nuk duhet t'i kalojmë.

لَا تُحَرِّمُوا طَيِّبَاتِ مَا أَحَلَّ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا

“Mos i ndaloni të mirat që u ka lejuar All-llahu juve dhe mos i kaloni kufijtë”

El-Maide 87

35] Ta dëgjosh (t'i nënshtrohesh, ta pasosh) pejgamberin në çdo gjë, do të thotë se e ke dëgjuar All-llahun.

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ ۚ وَمَنْ تَوَلَّىٰ فَمَا أَرْسَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ حَفِيظًا

“Kush dëgjon dhe i bindet të dërguarit ai veç e ka dëgjuar dhe i është bind All-llahut”

En-Nisa 80

36] Jeta dhe vdekja janë në dorën e All-llahut, mos iu frikëso askujt pos All-llahut. Puno për botën tjetër që ta takosh All-llahun me vepra të mira.

رَبِّ الَّذِي يُحْيِي وَيُمِيتُ

“Zoti im është Ai i cili ngjall dhe bënë që të vdiset”

El-Bekare 358

37| Allahu është shërues, përmbaju shkaqeve, shërohu dhe kërko prej All-llahut shërim.

وَإِذَا مَرِضْتُ فَهُوَ يَشْفِينِ

“Dhe kur të sëmurem ai më shëron”

Esh-Shuaraë 80

38| Nëse ke mundësi dhe të vjen rasti me iu bë padrejtësi njerëzve, kujtoje fuqinë e All-llahut ndaj teje.

قُلْ هُوَ الْقَادِرُ عَلَىٰ أَنْ يَبْعَثَ عَلَيْكُمْ عَذَابًا

“Thuaj: Ai ka mundësi që të dërgoj mbi ju dënim që të ju ndëshkoj”

El-En’am 65

وَهُوَ الْقَاهِرُ فَوْقَ عِبَادِهِ ۖ وَيُرْسِلْ عَلَيْكُمْ حَفَظَةً

“Ai është mbizotërues mbi robërit e Tij dhe dërgon mbi ju (melaqe) mbrojtës”

El-En’am 61

39| Nëse ke jetë të lumtur dhe begati prej All-llahut, kujdes dhe mos bëj mëkate, se mëkatet i largojnë begatitë nga ju.

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ

“Vërtetë, All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, deri sa mos të ndryshojnë çka ka në veten e tyre”

Err-Rread 11

40] Bëhu harmonik në ekzistencën dhe në krijesat, sepse çdo krijesë e lartëson dhe e lavdëron All-llahun pandërprerë.

كُلُّ قَدْ عَلِمَ صَلَاتَهُ وَتَسْبِيحَهُ ۖ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِمَا يَفْعَلُونَ

“Çdo gjë e di mënyrën se si t’i lutet atij dhe e lartëson e lavdëron All-llahun, All-llahu di çka veprojnë”

En-Nurë 41

41] Vështro qiellin si është krijuar, se si është zbukuruar me yje e planetë dhe mbushe zemrën me madhështinë e Krijuesit të Gjithëfuqishëm.

أَفَلَمْ يَنْظُرُوا إِلَى السَّمَاءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَاهَا وَزَيَّنَّاهَا

“A nuk po e vështrojnë (shikojnë) qiellin mbi veten e tyre se si është ndërtuar dhe stilizimin e saj (me yje e planetë)”

Kaf 6

42] Kujto Krijuesin i cili ta ka nënshtruar tokën, detin (ujin), ajrin dhe të gjitha gjallesat tjera.

لَتَسْتَبْشِرُوا عَلَى ظُهُورِهِمْ تَذْكُرُوا نِعْمَةَ رَبِّكُمْ إِذَا اسْتَوَيْتُمْ عَلَيْهِ وَتَقُولُوا سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ

“Lartësimi dhe madhërimi i qoftë Atij i cili na e ka nënshtruar këtë, sepse ne do të kishim qenë të paaftë dhe jemi të paaftë për të bërë diçka të tillë për ne”

Ez-Zuhruf 13

43] Ta dish se All-llahu na e ka nënshtruar (gjithçka) që ta shfrytëzojmë për mirësi dhe na e ka bërë tokën shtrojë (djep) për ta ndërtuar dhe për ta zhvilluar, e jo për ta shkatërruar.

وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ شَيْءٍ مَّوْزُونٍ

“Dhe tokën e Kemi shtrirë, e në të Kemi vendosur shtylla, dhe në të Kemi bërë që të mbijë prej gjithçkaje në masë dhe në sasi të caktuar, proporcionale dhe ekuilibruese”

El Hixhr 19

44] Përfjetoje dhe ndjej kënaqësi dhe nder në vete për të mirat që t'i ka dhënë All-llahu në pije dhe ushqim.

وَإِنَّ لَكُمْ فِي الْأَنْعَامِ لَعِبْرَةً ۖ نُسْقِيكُمْ مِمَّا فِي بُطُونِهَا وَلَكُمْ فِيهَا مَنَافِعُ كَثِيرَةٌ وَمِنْهَا تَأْكُلُونَ

“Dhe, për ju, në kafshë ka argumente, ju japim të pini atë çka ka në barqet e tyre, e prej tyre (kafshëve) përpos që keni dobi të shumta, prej tyre edhe hani”

El-Muëminunë 21

45] Kur sheh diçka interesante dhe që të habitë, mos e humb mendjen por thuaj: Ma shaa Allah.

وَلَوْلَا إِذْ دَخَلْتَ جَنَّتَكَ قُلْتَ مَا شَاءَ اللَّهُ لَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

“Çka ka dashur All-llahu. Nuk ka forcë as fuqi (për të krijuar diç të tillë) pos All-llahut”

El-Kehf 39

46] Njihe All-llahun deri sa ta plotësosh imanin (pra, mos u mjafto me pak dije).

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۚ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ۚ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۚ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ ۚ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۚ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

“All-llahu është një, nuk ka Zot pos Tij, Ai është i gjallë dhe i përjetshëm, nuk e zë kotja, lodhja e as gjumi, të Tij janë çka ka në qiej e në tokë, kush mund të ndërmjetësoj te Ai, pos me lejen e Tij. Di çka ka para tyre dhe çka ka (do të ketë) pas tyre. Dhe nuk mund të përfshijnë diçka prej diturisë së Tij, vetëm sa dëshiron Ai. Përfshinë frontin e qiejve dhe të tokës dhe nuk lodhet duke i ruajtur (mirëmbajtur) ngase Ai është i Lartë, i Madh”

El-Bekare 255 (Ajetul Kursija).

47] Kur ta plotësosh imanin në All-llahun dhe të bindesh tërësisht thuaj me bindje të plotë:

أَلَيْسَ اللَّهُ بِكَافٍ عَبْدَهُ

“A nuk është All-llahu që i mjafton robit të vet”

Ez-Zumer 36

أَلَيْسَ اللَّهُ بِعَزِيزٍ ذِي انْتِقَامٍ

“A nuk është All-llahu i gjithëfuqishëm që ndërmerr ndëshkime”

Ez-Zumer 37

أَلَيْسَ ذَلِكَ بِقَادِرٍ عَلَىٰ أَنْ يُحْيِيَ الْمَوْتَىٰ

“A nuk ka mundësi All-llahu t'i ngjallë të vdekurit”

El-Kijame 40

أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمِ الْحَاكِمِينَ

“A nuk është All-llahu më i urti i gjykuesve”

Et-Tinë 8

...أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَعْلَمَ بِالشَّاكِرِينَ

“A nuk i di All-llahu ata që falënderojnë”

El-En’am 53

...قَالَ أَلَيْسَ هَذَا بِالْحَقِّ

“A nuk është kjo e vërtetë dhe me drejtësi”

El-En’am 30

Pastaj çdo gjë në gjithësi përgjigjet me ty: **“Po gjithsesi, Ky është Zoti ynë”**.

48 Islami është begati, begati e pakufishme të cilën ta ka dhënë All-llahu dhe të ka udhëzuar dhe ta ka plotësuar besimin.

قُلْ لَا تَمْنُوا عَلَيَّ إِسْلَامَكُمْ ۖ بَلِ اللَّهُ يَمُنُّ عَلَيْكُمْ أَنْ هَدَاكُمْ لِلْإِيمَانِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ

“Thuaj: Pranimin tuaj të fesë Islame mos ma tregoni për të ma njoftuar mua, por nëse jeni të sinqertë, (ta dini se) All-llahu juve ju bëri mirë, kur ju udhëzoi për besim”

El-Huxhurat 7

49 Pasuria, fëmijët, shëndeti, dituria, të gjitha këto janë begati, ajri është begati. Kujtoji të mirat e All-llahut të cilat janë të shumënumërta dhe të pakufishme.

وَمَا بِكُمْ مِّنْ نُّعْمَةٍ فَمِنَ اللَّهِ

“Çdo e mirë dhe çdo begati është prej All-llahut”

En-Nahl 53

SEKTET DHE DREJTIMET SHKATËRRUESE

50| Çdo njeri që të tjerët i quan mëkatarë të mëdhenj por pa argumente, dhe të tjerët i shpie në humbje dhe polemizon për All-llahun pa njohuri, dhe pa dije, për të do të ketë nënçmim në këtë dunja dhe në botën tjetër do të ketë dënim të dhimbshëm.

وَمِنَ النَّاسِ مَن يُجَادِلُ فِي اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ وَلَا هُدًى وَلَا كِتَابٍ مُّنِيرٍ * ثَائِي عِطْفِهِ لِيُضِلَّ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ ۖ لَهُ فِي الدُّنْيَا خِزْيٌ ۖ وَنُذِيقُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عَذَابَ الْحَرِيقِ

“Ka disa prej njerëzve të cilët për All-llahun polemizojnë pa kurrfarë diturie, pa kurrfarë udhëzimi e argumenti dhe pa libër ndriçues (të besueshëm) dhe pasojnë çdo shejtan të krekosur. Është shkruar për atë i cili e bën shok atë do ta humb nga udha e drejtë dhe e orienton në dënim të zjarrit”

El-Haxh 8-9

51| Kush i pason të humburit apo i imiton ato, ose polemizon në çështjet e All-llahut, si ringjallja, llogaria, pa argument logjik, apo pa argument Kur'anor apo të hadithit ai do të digjet në zjarr.

وَمِنَ النَّاسِ مَن يُجَادِلُ فِي اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ وَيَتَّبِعُ كُلَّ شَيْطَانٍ مَّرِيدٍ * كُتِبَ عَلَيْهِ أَنَّهُ مَن تَوَلَّاهُ فَأَنَّهُ يُضِلُّهُ وَيَهْدِيهِ إِلَى عَذَابِ السَّعِيرِ

“Ka disa prej njerëzve të cilët polemizojnë për çështjen e All-llahut pa kurrfarë diturie, dhe pasojnë çdo djall (shejtan) të mallkuar. Është përcaktuar se kush e pason atë, ai do ta humb dhe do ta shpie në dënimin e zjarrit të xhehenemit”

El-Haxh 3-4

52] Të luhatshëm në besim janë ata të cilët nuk janë të vendosur asnjëherë, ata lakojnë çdo herë varësisht prej dëmeve dhe dobive, dhe bëjnë tregti me fe, nuk janë të bindur, për këtë arsye ata do ta humbin edhe këtë botë edhe botën tjetër.

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَعْبُدُ اللَّهَ عَلَى حَرْفٍ ۖ فَإِنْ أَصَابَهُ خَيْرٌ اطْمَأَنَّ بِهِ ۖ وَإِنْ أَصَابَتْهُ فِتْنَةٌ انْقَلَبَ عَلَىٰ وَجْهِهِ خَسِرَ الدُّنْيَا وَالْآخِرَةَ ۚ ذَٰلِكَ هُوَ الْخُسْرَانُ الْمُبِينُ

“Ka prej njerëzve që adhurojnë All-llahun njëanshëm, nëse e kaplon e mira qetësohet në të, e nëse e kaplon e keqja dhe sprovimi, e lakon fytyrën e tij, kështu ai e humb edhe këtë botë edhe botën tjetër. Kjo është me të vërtetë humbje e sigurt”

El-Haxh 11

53] Dije se nuk ka mbrojtës pos All-llahut, mbështetu në Të dhe kërko siguri tek Ai kundër armiqve dhe cytësve. Ta dish, All-llahu është Zoti yt, Krijuesi yt, Planifikuesi i çështjeve tua, zbatues i planeve tua dhe ruajtësi i planeve të cilat i ka planifikuar Ai.

وَمَن يَعْصِمْ بِاللَّهِ فَقَدْ هُدِيَ إِلَىٰ صِرَاطٍ مُّسْتَقِيمٍ

“Dhe kush mbështetet te All-llahu, Ai është i udhëzuar në rrugën e drejtë”

Ali Imran 101

قَالَ اللَّهُ خَيْرٌ حَافِظًا ۖ وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ

“All-llahu është ruajtësi më i mirë, dhe Ai është mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve”

Jusuf 64

وَهُدُوا إِلَى الطَّيِّبِ مِنَ الْقَوْلِ وَهُدُوا إِلَىٰ صِرَاطِ الْحَمِيدِ

“Dhe udhëzoni me fjalët e mira, dhe udhëzoni në rrugën e drejtë të lavdëruar”

El-Haxh 24

ME SHOQËRINË DHE RRETHIN KU JETON

-E TRETA-

**Bazat dhe parimet e Kur'anit të cilat rregullojnë marrëdhëniet e
njeriut me shoqërinë**

1 Pas All-llahut, prindërit kanë përparësi që t'i duash dhe t'u bësh mirë më shumë se të tjerëve.

وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

“Dhe prindërve bëju mirë”

El-Bekare 83

2 Me prindërit sillu butësisht, folu fjalë të mira dhe lutu që të fitojnë mëshirën e All-llahut.

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ۚ إِمَّا يَبْلُغَنَّ عِنْدَكَ الْكِبَرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أُفٍّ وَلَا تَنْهَرْهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا *

وَاخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ الذُّلِّ مِنَ الرَّحْمَةِ وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا

“Dhe mos iu thuaj as of, mos iu bërtit, por folu me fjalë të mira dhe fisnike, shtrijë kraharorët e butësisë me ta dhe lutu e thuaj: “O Zoti im, mëshiroi ata ashtu siç kanë qenë të sjellshëm kur kam qenë i vogël”

El-Isra 23,24

3 Vepro që të fitosh kënaqësinë e prindërve dhe kërko që të t'i falin ty gabimet, sepse kënaqësia e tyre ndaj teje është kënaqësia e All-llahut.

قَالُوا يَا أَبَانَا اسْتَغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا إِنَّا كُنَّا خَاطِئِينَ *

قَالَ سَوْفَ أَسْتَغْفِرُ لَكُمْ رَبِّي ۖ إِنَّهُ هُوَ الْعَفُوُّ الرَّحِيمُ

“Thanë: O babai ynë, falna gabimet tona, se me të vërtetë ne kemi qenë gabimtarë. (Jaëkubi) Tha: - Zoti im do t'ua falë, vërtetë Ai është Falës i Mëshirshëm”

Jusuf 97, 98

4 Babai e ka vendin më të ngritur në familje, me atë duhet konsultuar dhe prej atij leje duhet kërkuar.

فَلَنْ أَبْرَحَ الْأَرْضَ حَتَّى يَأْذَنَ لِي أَبِي

“Nuk do të lëvizim nga këtu (nga ky vend) deri sa të më jep leje baba im”

Jusuf 80

5 Prindin duhet dëgjuar, se duke e dëgjuar atë e ke dëgjuar All-llahun.

سَتَجِدُنِي إِنْ شَاءَ اللَّهُ مِنَ الصَّابِرِينَ

“O baba im, vepro ashtu siç je urdhëruar, se do ta kuptosh, nëse All-llahu do, do të jem prej durimtarëve”

Es-Safat 102

6 Vëllai e forcon litarin e vëllait të tij dhe bëhen të fuqishëm.

قَالَ سَنَشُدُّ عَضُدَكَ بِأَخِيكَ وَنَجْعَلُ لَكُمَا سُلْطَانًا

“Tha: do ta përforcojmë kraharorin tënd me vëllanë tënd, dhe do t’u japim që të dyve fuqi për pushtet”

El-Kasas 35

7 Vëllazëria ka të drejta dhe obligime. Dëshiro për vëllanë atë që e do për vete dhe lutu për vete dhe lutu për të.

قَالَ رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِأَخِي وَأَدْخِلْنَا فِي رَحْمَتِكَ ۖ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ

“Tha: O Zoti im, më fal mua dhe vëllanë tim dhe na mbulo neve me mëshirën Tënde”

El-Earaf 151

8| Vëllezërit duhet t'i planifikojnë çështjet së bashku dhe së bashku të planifikojnë për shpëtimin nga grackat e përgatitura.

وَقَالَ يَا بَنِيَّ لَا تَدْخُلُوا مِنْ بَابٍ وَاحِدٍ وَادْخُلُوا مِنْ أَبْوَابٍ مُتَفَرِّقَةٍ

“O bijtë e mi, mos hyni vetëm nga një derë, por hyni nga dyer të ndryshme”

Jusuf 67

9| Dashuria, respekti dhe mëshira në mes të farefisit është prej urdhrave të All-llahut, andaj duhet t'i mbajmë dhe t'i forcojmë marrëdhëniet farefisnore.

وَأُولُوا الْأَرْحَامِ بَعْضُهُمْ أَوْلَىٰ بِبَعْضٍ

“Dhe farefisi ka përparësi në marrëdhënie të ndërsjella”

El-Enfal 75

10| Ndaj të afërtit në familje ka obligime dhe detyra.

فَاتِ ذَا الْقُرْبَىٰ حَقَّهُ

“Dhe, kryeje obligimin dhe detyrën ndaj të afërtit”

Err-Rum 38

11| Cilësi e muslimanit është që gjithmonë të flasë fjalë të mira.

وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا

“Dhe silluni mirë me njerëzit (e flitni fjalë të mira)”

El-Bekare 83

12 Shoqëria e besimit është shoqëri e vëllazërimit, shoqëri e pajtimit mes vëllezërve dhe shoqëri e devotshmërisë.

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأَصْلِحُوا بَيْنَ أَخَوَيْكُمْ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ

“Vërtetë besimtarët janë vëllezër, andaj pajtoni vëllezërit mes vete dhe frikësojuni All-llahut”

El-Huxhurat 9

13 Zemrat e besimtarëve duhet të jenë të pajisura me dashuri, duhet të jenë të pastra ndaj çdo zilie dhe urrejtje ndaj besimtarëve.

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ

“O Zot falna ne dhe vëllezërit besimtarë para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë urrejtje ndaj atyre që kanë besuar. O Zoti ynë, vërtetë ti je i butë, i mëshirshëm”

El-Hashr 10

14 Me fqinjët duhet të sillemi mirë, t’u flasim fjalë të mira pa marrë parasysh a kemi lidhje farefisnore apo jo.

وَالْجَارِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَالْجَارِ الْجُنُبِ

“Dhe fqinjit të afërt me të cilin keni lidhje farefisnore, po ashtu edhe fqinjit të afërt (me të cilin nuk keni lidhje farefisnore)”

En-Nisa 36

15 Me u sjellë mirë dhe me i fol fjalë të mira shokut të klasës, shokut të punës, shokut të udhëtimit.

وَالصَّاحِبِ بِالْجَنبِ

“Dhe shokut në afërsi”

En-Nisa 36

16 Udhëtarit i cili ka mbetur pa mjete financiare për t’u kthyer në vendlindje është obligim i yni që t’i ndihmojmë dhe t’i bëjmë mirë.

وَابْنِ السَّبِيلِ

“Dhe udhëtarit (i cili nuk ka mjete për t’u kthyer në vendlindje)”

En-Nisa 36

17 Me jetimin mos u sjell ashpër.

فَأَمَّا الْيَتِيمَ فَلَا تَقْهَرْ

“Dhe jetimit mos i fol me ashpërsi”

Ed-Duha 9

18 Lypësin mos e refuzo.

وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ

“Dhe lypësin mos e refuzo”

Ed-Duha 10

19 Muslimani e ka të ndaluar që të cenojë të drejtën e muslimanit duke filluar prej vrasjes e çdo gjë tjetër.

وَمَنْ يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُتَعَمِّدًا فَنَجَزَاؤُهُ جَهَنَّمُ خَالِدًا فِيهَا وَغَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُ

“Dhe kush vret muslimanin me qëllim, ai do të dënohet në xhehenem, përgjithmonë të qëndrojë në të, All-llahu do të jetë i hidhëruar dhe do ta mallkojë”

En-Nisa 93

20 Muslimani e ka të ndaluar të prek në pasurinë e muslimanit, përpos asaj çka është e lejuar me shariat.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُم بَيْنَكُم بِالْبَاطِلِ

“O besimtarë mos e hani pasurinë tuaj (të njëri-tjetrit) me padrejtësi”

En-Nisa 29

21 Personaliteti i muslimanit është i nderuar pa marrë parasysh a është prezent apo jo, ai i cili prek nderin e tij është mëkatar.

وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ

“Ne veç e kemi fisnikëruar njeriun (birin e Ademit)”

El-Isra 80

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا يَسْخَرُ قَوْمٌ مِّن قَوْمٍ عَسَىٰ أَن يَكُونُوا خَيْرًا مِّنْهُمْ وَلَا نِسَاءٌ مِّن نِّسَاءٍ عَسَىٰ أَن يَكُنَّ خَيْرًا مِّنْهُنَّ ۚ وَلَا تَلْمِزُوا أَنْفُسَكُمْ وَلَا تَنَابَزُوا بِالْأَلْقَابِ ۚ بِئْسَ الْإِسْمُ الْفُسُوقُ بَعْدَ الْإِيمَانِ

“Mos të tallet një popull me një popull tjetër se ndoshta të tallurit janë më të mirë se tallësit, as gratë me gratë tjera, se ndoshta ata janë më të mira se tjerat, dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq”

El-Huxhurat 11

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ إِثْمٌ ۖ وَلَا تَجَسَّسُوا

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat, dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit”

El-Huxhurat 12

22 Shoqëria islame është shoqëri nderi, pastërtie, sinqeriteti dhe çiltërsie.

إِنَّ الَّذِينَ يُحِبُّونَ أَن تَشِيعَ الْفَاحِشَةُ فِي الَّذِينَ آمَنُوا لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ

“Ata të cilët dëshirojnë të përhapin imoralitetin tek ata të cilët kanë besuar, për ata ka dënim të dhimbshëm në këtë botë dhe në botën tjetër”

En-Nur 19

23 Rregullat e dashurisë, respektit dhe simpatisë, Zoti i Madhëruar i ka caktuar në vendkuvendimet e muslimanëve.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قِيلَ لَكُم تَفَسَّحُوا فِي الْمَجَالِسِ فَافْسَحُوا يَفْسَحِ اللَّهُ لَكُم

“Nëse u thuhet në vendkuvendime ngrihuni (dhe lëshoni vend) vendit, ngrihuni se Zoti zgjeron vendin për ju”

El-Muxhadele 11

24 Urtësia është simbol i muslimanit. Selami është përshëndetja e tyre.

وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا وَإِذَا خَاطَبَهُمُ الْجَاهِلُونَ قَالُوا سَلَامًا

“Dhe kur të bisedojnë me injorantët u thonë atyre “selam” (paqja qoftë mbi ju)”

El-Furkan 63

25| Polemikat dhe diskutimi duhet të bëhen me dialogë të afërimit dhe mirëkuptimit.

وَالْمَوْعِظَةُ الْحَسَنَةُ

“Dhe diskuto me to për çështjet që janë më të mira”

En-Nahl 125

ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ

“Ktheja tjerëve me të mirë, atëherë mes teje dhe mes atyre që kanë armiqësi ndaj teje do të fillojë afria dhe shoqëria e besimit dhe dashurisë”

Fusilet 34

26| Edukata e pejgamberit është mostra e shkëlqyeshme e muslimanëve.

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ ۖ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ ۚ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ ۚ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ

“Dhe, me mëshirën e All-llahut ke qenë i butë ndaj tyre. Po të kishe qenë i rreptë, i ashpër dhe zemërgurë nuk do të kishin qenë pranë teje, andaj:

fali ata,

kërko falje për ta,

këshillohu me ta për çdo çështje,

dhe pasi të marrësh vendimin përfundimtarë mbështetju vetëm

Allahut”

Ali Imran 159

27| Fjalët e buta janë simbole të çdo besimtari të devotshëm.

فَقُولَا لَهُ قَوْلًا لَّيِّنًا لَّعَلَّهُ يَتَذَكَّرُ أَوْ يَخْشَىٰ

“Dhe bisedoni ju dy me ta me fjalë të buta, se ndoshta mendon dhe frikësohet (e kthehet në rrugë të drejtë)”

TAHA 44

28| Vajzës nuk i ka hije të flasë me fjalë provokuese pasi pa dashje mund t'i nxisë ata të cilët i kanë zemrat e sëmura, andaj gjithmonë le të flasë fjalë të mira dhe të matura.

إِنِ اتَّقَيْتُنَّ فَلَا تَخْضَعْنَ بِالْقَوْلِ فَيَطْمَعَ الَّذِي فِي قَلْبِهِ مَرَضٌ وَقُلْنَ قَوْلًا مَّعْرُوفًا

“Dhe le të mos provokojnë me fjalë, me qëllim që të nxisin atë i cili ka zemër të sëmurë dhe le të flasin fjalë të mira”

El Ahzab 32

29| Të drejtat e njeriut duhet të çmohen, të vlerësohen dhe nuk duhet cenuar.

وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ

“Dhe mos ua pakësoni njerëzve pasuritë e tyre”

El-Earaf 85

30| Duhet t'i ndihmosh atij i cili meriton t'i ndihmohet, por nuk ka nevojë ta ndihmosh atë që nuk e meriton të ndihmohet.

مَنْ يَشْفَعْ شَفَاعَةً حَسَنَةً يَّكُنْ لَهُ نَصِيبٌ مِّنْهَا ۖ وَمَنْ يَشْفَعْ شَفَاعَةً سَيِّئَةً يَّكُنْ لَهُ كِفْلٌ مِّنْهَا

“Kush ofron ndihmë të mirë, do të ketë pjesë nga ajo dhe kush ofron ndihmë për ndonjë të keqe do të ngarkohet me të”

En-Nisa 85

31] Muslimani, në shoqëri duhet të luaj rolin e ndërtuesit, zhvilluesit, e jo shkatërruesit.

وَلَا تَعَاوُنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ

“Dhe ndihmoni njëri-tjetrin në mirësi dhe devotshmëri dhe mos i ndihmoni njëri-tjetrit në mëkate dhe armiqësi”

El-Maide 2

32] Çdo musliman duhet të veproj në ndërprerjen e luftës dhe duhet të angazhohet për paqe dhe pajtim.

وَإِنْ طَائِفَتَانِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا

“Dhe, nëse dy grupe të muslimanëve luftojnë mes vete ju pajtoni në mes tyre”

El-Huxhurat 9

33] Paqja duhet ruajtur, ndërsa agresorin dhe kriminelin duhet ndalur.

فَإِنْ بَعَثَ إِحْدَاهُمَا عَلَى الْآخَرَىٰ فَقاتِلُوا الَّتِي تَبْغِي حَتَّىٰ تَفِيءَ إِلَىٰ أَمْرِ اللَّهِ ۚ فَإِنْ فَاءَتْ فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا بِالْعَدْلِ وَأَقْسِطُوا ۚ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ

“Dhe nëse njëra (grup) i tejkalon kufijtë (nuk pranon pajtim) dhe sulmon tjetrën (grup) luftojeni atë e cila sulmon (nuk do pajtim) deri sa të qetësohet dhe të pajtohet me ligjin e All-llahut”

El-Huxhurat 9

34] Drejtësia është simbol dhe specifikë e muslimanëve dhe kjo urdhërohet edhe në çështje të dënimeve (ligjore) sepse All-llahu nuk i do agresorët.

وَإِنْ عَاقَبْتُمْ فَعَاقِبُوا بِمِثْلِ مَا عُوقِبْتُمْ بِهِ

“Nëse dënoni, dënoni ashtu siç jeni dëmtuar”

En-Nahl 126

فَإِنْ فَاءَتْ فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا بِالْعَدْلِ وَأَقْسِطُوا ۚ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ

“Dhe nëse qetësohet pajtoni mes vete me drejtësi dhe veproni me drejtësi se vërtetë All-llahu i do të drejtit”

El-Huxhurat 9

35] Muslimani duhet ta zbuloj realitetin dhe të vërtetën dhe duhet t'i konfirmoj lajmet në mënyrë që të mos bie në gabim e pastaj të pendohet.

إِنْ جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَنْ تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْحَبُوا عَلَىٰ مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ

“Nëse u vjen ndonjë mëkatar me ndonjë lajm vërtetoheni që të mos bini sikurse popujt injorant e pastaj të pendoheni për atë çka keni vepruar”

El-Huxhurat 6

36] Edukatë e muslimanit është që të largohet nga fjalët e pamoralshme dhe ofenduese dhe nga ajo çka nuk i përket atij.

وَإِذَا سَمِعُوا اللَّعْنَ أَعْرَضُوا عَنْهُ وَقَالُوا لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ لَا تَبْتَغِي

الْجَاهِلِينَ

“Dhe kur të dëgjojnë fjalë të ndyta largohen nga aty dhe thonë: Ne kemi punët tona, ju keni punët e juaja “Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ju!?” Ne nuk na takon të jemi injorant”

Kasas 55

37] Besimtari nuk flet haptazi (as fshehtazi) për imoralitet dhe të këqija, sepse këtë All-llahu nuk e dëshiron.

يَا لَّا يُحِبُّ اللَّهُ الْجَهْرَ بِالسُّوءِ مِنَ الْقَوْلِ إِلَّا مَنْ ظَلَمَ

“All-llahu nuk do që të flitet dhe të përhapet e keqja me fjalë (por kjo lejohet) vetëm nëse dikujt i është bërë padrejtësi”

En-Nisa 148

38] Besimtari nuk kuvendon për mëkat dhe armiqësi.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا تَنَاجَيْتُمْ فَلَا تَتَنَاجَوْا بِالْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ

“O besimtarë kur të kuvendoni, mos kuvendoni për mëkat dhe armiqësi”

El-Muxhadele 9

39] Besimtari është i moralshëm, fisnik dhe përshëndetjen e kthen me të mirë.

وَإِذَا حُيِّتُمْ بِتَحِيَّةٍ فَحَيُّوا بِأَحْسَنَ مِنْهَا أَوْ رُدُّوهَا

“Dhe nëse përshëndeteni me ndonjë përshëndetje, atëherë përshëndetni më mirë se ajo, ose së paku kthejeni atë”

En-Nisa 89

40] Gratë janë motrat e meshkujve, nuk e urrejnë njëri-tjetrin por ndihmohen mes vete.

وَلَا تَتَمَنَّوْا مَا فَضَّلَ اللَّهُ بِهِ بَعْضَكُمْ عَلَى بَعْضٍ ۚ لِلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا اكْتَسَبُوا ۚ وَلِلنِّسَاءِ
نَصِيبٌ مِّمَّا اكْتَسَبْنَ ۚ وَاسْأَلُوا اللَّهَ مِنْ فَضْلِهِ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا

“Dhe mos lakmoni për vete atë që All-llahu disa prej tjerëve i ka dalluar (me disa specifika). Meshkujve u takon çka kanë fituar ndërsa edhe femrave u takon çka kanë fituar, dhe luteni All-llahun për të mirat e Tij”

En-Nisa 32

41] Ne duhet t'i vlerësojmë njerëzit me vlera dhe t'ua japim respektin e merituar.

لَا تَرْفَعُوا أَصْوَاتَكُمْ فَوْقَ صَوْتِ النَّبِيِّ

“Mos e ngritni zërin mbi zërin e peygamberit”

El-Huxhurat 2

وَلَا تَجْهَرُوا لَهُ بِالْقَوْلِ كَجَهْرِ بَعْضِكُمْ لِبَعْضٍ

“Dhe mos flitni me të me zë të lartë siç flitni mes vete me njëri-tjetrin”

El Huxhurat 3

لَا تَجْعَلُوا دُعَاءَ الرَّسُولِ بَيْنَكُمْ كَدُعَاءِ بَعْضِكُمْ بَعْضًا

“Dhe mos e thirrni të dërguarin ashtu siç e thirrni njëri-tjetrin”

En-Nurë 63

42] Me mendimtarët dhe të mençurit duhet konsultuar dhe duhet të marrim mësim prej tyre.

وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ ۖ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ

“Dhe konsultohu për çdo çështje, dhe pasi ta marrësh vendimin përfundimtar mbështetju vetëm All-llahut”

Ali Imran 159

43] Shit-blerja duhet të bazohet në besnikëri, drejtësi, sepse ato janë simbol i besimtarit.

فَأَوْفُوا الْكَيْلَ وَالْمِيزَانَ وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ

“Plotësoni matjen në peshë dhe sasi dhe mos ua pakësoni njerëzve mallrat e tyre”

El-Earaf 85

فَإِنْ أَمِنَ بَعْضُكُم بَعْضًا فَلْيُؤَدِّ الَّذِي اؤْتُمِنَ أَمَانَتَهُ وَلْيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ

“Dhe nëse keni besim në njëri-tjetrin, atëherë ai i cili e ka marrë në besim një çështje le ta qojë në vendin e kërkuar”

El-Bekare 283

44] Butësia me njerëzit sjell deri te kryerja e detyrave. Mbajtja e sekretit ndihmon në kryerjen e detyrave. Zgjedhja e mirë është ushqimi më i mirë të cilin njeriu e posedon prej Krijuesit të gjithësisë.

فَلْيَنْظُرْ أَيُّهَا أَزْكَىٰ طَعَامًا فَلْيَأْتِكُمْ بِرِزْقٍ مِّنْهُ وَلْيَتَلَطَّفْ وَلَا يُشْعِرَنَّ بِكُمْ أَحَدًا

“Le të shikoj ndonjëri ku ka ushqim më të mirë dhe le të bjer furnizim (ushqim) prej tij. Le të sillet butësisht dhe mos ta hetojë askush atë (as juve)”

El-Kehf 19

45] Bashkimi është fuqi ndërsa ndarja dobësi.

وَاعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا

“Dhe përmbahuni të gjithë së bashku për librin (litarin) e All-llahut dhe mos u ndani”

Ali Imran 103

46] Konfrontimi dhe kundërshtimi i ndërsjellë shpie në dështim dhe dobësi.

وَلَا تَنَازَعُوا فَتَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ

“Dhe mos u konfrontoni mes vete se menjëherë u humb (reputacioni) era e mirë të cilën e posedoni”

El-Enfal 46

47] Garimi në punë të mira është i pëlqyer.

فَاسْتَبِقُوا الْحَيَاتِ

“Dhe garoni në punë të mira”

El-Bekare 148

48] Të gjithë ne jemi një popull-Umet, ky unifikim është prej All-llahut dhe duhet ta ruajmë unitetin.

إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ

“Vërtetë ky është umeti juaj Një, ndërsa Unë jam Zoti i Juaj, dhe vetëm mua më adhuron”.

(El-Enbija 92)

49] Allahu është kujdestar i vijës tonë, Ai i di pengesat të cilat do t'na pengojnë.

قَدْ يَعْلَمُ اللَّهُ الْمُعَوِّقِينَ مِنْكُمْ وَالْقَائِلِينَ لِإِخْوَانِهِمْ هَلُمَّ إِلَيْنَا ۚ وَلَا يَأْتُونَ الْبَأْسَ إِلَّا قَلِيلًا

“All-llahu i ka njohur shumë mirë ata që ndër ju pengonin dhe ata që vëllezërve të vet u thoshin: Ejani me ne! E prej atyre, nuk vijnë në luftë përpos një pakice”

El-Ahzab 18

50] Të larguarit nga kriminelët është fitim.

وَلَا تَرْكُنُوا إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا فَتَمَسَّكُمُ النَّارُ

“Dhe mos u mbështet në ata të cilët bëjnë krime se do t’ju përfshijë zjarri”

Hud 113

51] Muslimani nuk pranon padrejtësi prej tjetrit, por as nuk i bën padrejtësi vetes e as tjetrit.

لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ

“Mos bëni padrejtësi dhe mos lejoni t’u bëhet padrejtësi”

El-Bekare 279

52] I riu musliman e ka obligim të profesionalizohet në shkencën e fikhut të fesë në mënyrë që ta këshilloj popullin e tij.

وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنفِرُوا كَافَّةً ۚ فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ
وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ

“E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkoj një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata në mënyrë që ata ta kuptojnë e të ruhen”

Et-Tevbe 122

53] Muslimani gjithmonë përqendrohet në drejtësi dhe e thotë të vërtetën edhe nëse është në dëm të vetvetes.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ بِالْقِسْطِ شُهَدَاءَ لِلَّهِ وَلَوْ عَلَىٰ أَنفُسِكُمْ أَوِ الْوَالِدِينَ
وَالْأَقْرَبِينَ ۚ إِن يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَكِيرًا فَالِلَّهِ أُولَىٰ ۖ بِهِمَا ۖ فَلَا تَتَّبِعُوا الْهَوَىٰ أَن تَعْدِلُوا ۚ وَإِن تَلُؤْا
أَوْ تُعْرِضُوا فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا

“Bëhuni dëshmues të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) të vetvetes suaj, kundër prindërve, ose kundër të afërmve, le të jetë ai pasanik ose varfanjak, dëshmia para All-llahut ka prioritet ndaj tyre. Pra, mos ndiqni emocionin e t’i shmangeni drejtësisë”

En-Nisa 135

54] All-llahu është i drejtë, e do të drejtën, e ne e kemi obligim që ta qesim të drejtën në shesh.

وَلَا تَلْبِسُوا الْحَقَّ بِالْبَاطِلِ وَتَكُنُوا الْحَقَّ وَانْتُمْ تَعْلَمُونَ

“Mos e mbuloni të vërtetën me të pavërtetën ashtu që e fshihni të vërtetën ndërsa ju e dini”

El-Bekare 42

55| Është obligim mbajtja e besës dhe kryerja e premtimeve. Obligim është ndërlidhja farefisnore. Toka duhet të zhvillohet.

الَّذِينَ يَنْقُضُونَ عَهْدَ اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مِيثَاقِهِ وَيَقْطَعُونَ مَا أَمَرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ يُوصَلَ وَيُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ ۖ أُولَٰئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ

“Ata që e thyejnë besën e dhënë All-llahut, pasi që ajo është lidhur, dhe e këpusin atë që All-llahu ka urdhëruar të jetë e ndërlidhur, e edhe bëjnë shkatërrime në tokë, ata janë të humburit dhe të dështuarit”

El-Bekare 27

56| Ulja e shikimit dhe ruajtja e nderit është urdhër i All-llahut edhe për besimtarët edhe për besimtare.

قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَعْضُوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ وَيَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ

“Thuaj besimtarëve le të ulin shikimet e tyre dhe le t’i ruajnë organet e turpshme të tyre”

En-Nurë 30

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَعْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ

“Thuaj besimtareve le të ulin shikimet e tyre dhe le t’i ruajnë organet e turpshme të tyre”

En-Nurë 31

57| Shtëpitë janë të shenjta, ato duhet ruajtur. Për vizitat nëpër shtëpi ekzistojnë rregulla dhe norma të cilat janë edhe për vizitorin edhe për të vizituarin.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّى تَسْتَأْذِنُوا وَتُسَلِّمُوا عَلَى أَهْلِهَا

“Mos hyni në shtëpi tjera, pos shtëpive tuaja deri sa t’u jepet leja për të hyrë dhe deri sa t’i përshëndetni banorët (pronarët) e asaj shtëpie”

En-Nurë 27

وَأَتُوا الْبُيُوتَ مِنْ أَبْوَابِهَا

“Hyni nëpër shtëpi nëpër dyert e tyre”

El-Bekare 189

فَإِذَا دَخَلْتُمْ بُيُوتًا فَسَلِّمُوا عَلَى أَنْفُسِكُمْ تَحِيَّةً مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ مُبَارَكَةً طَيِّبَةً

“Dhe kur të hyni në shtëpi (tua) përshëndetni me selam, se kjo përshëndetja është kërkesë prej All-llahut”

En-Nurë 61

58| Fëmijët kur të hyjnë në moshën e pjekurisë (bulug) le të kërkojnë leje.

وَإِذَا بَلَغَ الْأَطْفَالُ مِنْكُمُ الْحُلُمَ فَلْيَسْتَأْذِنُوا

“Dhe kur fëmijët e juaj arrijnë moshën e pjekurisë le të kërkojnë leje (para se me hy në dhomat tua)”

En-Nurë 59

59| Elementi më i rrezikshëm në shoqëri është hipokrizia. I rrezikshëm është ai i cili kur flet rrenë, premtion e nuk realizon, i besohet e tradhton, ai i cili e thotë atë çka nuk e ka në zemër por vetëm proklamohet.

إِنَّ الْمُنَافِقِينَ فِي الدَّرَكِ الْأَسْفَلِ مِنَ النَّارِ وَلَنْ يَجِدَهُمْ نَصِيرًا

“Vërtet, hipokritët janë në shkallën më të ultë të zjarrit, dhe nuk ka për ta ndihmëtar”

En-Nisa 145

60| Mos kërko mbështetje dhe ndihmë prej armiqve të fesë dhe prej pabesimtarëve sepse ajo është cilësi e hipokritëve. Fuqia i takon Allahut, të dërguarit të tij dhe besimtarëve.

بَشِّرِ الْمُنَافِقِينَ بِأَنَّ لَهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا * الَّذِينَ يَتَّخِذُونَ الْكَافِرِينَ أَوْلِيَاءَ مِنْ دُونِ الْمُؤْمِنِينَ ۚ أَيْتَعُونَ عِنْدَهُمُ الْعِزَّةَ فَإِنَّ الْعِزَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا

“Përgëzoj hipokritët se për ta ka dënim të dhimbshëm, ata të cilët i marrin pabesimtarët mbrojtës dhe dashamirë përpos besimtarëve. A te ato po kërkojnë fuqi, kur dihet se fuqia e Allahut është mbi të gjithë”

En-Nisa 138, 139

BAZAT E ETIKËS DHE PARIMET EDUKIMITT TË CILAT I PËRMBAHEN AJETET E KUR'ANIT FISNIK

E para: Parimet për përmirësimin e vetes

E dyta: Parimet për forcimin e Besimit

E treta: Parimet për përmirësimin e gjendjes shoqërore

E para: Parimet për përmirësimin e vetes

- 1** Mendo në veten tënde, mendo në veten si je krijuar? Prej çka je krijuar? Ai i cili e njeh (kupton) veten e tij, ai e njeh Zotin dhe Krijuesin e tij.
- 2** Shiko në veten tënde dhe përsosi vlerat tua. Zhvillimi i shoqërisë fillon prej zhvillimit të individit.
- 3** Atëherë kur njeriu e përsos moralin dhe karakterin e tij, atëherë nuk mund t'i bën dëm askush.
- 4** Shpëtimtar dhe fitimtar është ai i cili e pastron veten e tij dhe i përulet vetëm Zotit të tij. I dështuar dhe i humbur është ai i cili e njollos veten e tij me mëkate.
- 5** Në trup ka epshe dhe pasione, mos iu nënshtro epsheve dhe pasioneve në mëkate sepse epshi urdhëron në të keqe.
- 6** Ti je përgjegjës para All-llahut për lëvizjet e tua, dhe dije se do të jesh përgjegjës për çdo gjë (qofshin edhe më të imtat).
- 7** Çka të veprosh për atë do të paguhesh (shpërblehesh).
- 8** Trupi yt është amanet në duart tua, për këtë arsye ti je përgjegjës për mbrojtjen e tij nga zjarri.
- 9** Edukoje veten që të duroj se durimi është gjysma e imanit.
- 10** Për çdo çështje, para se ta qortosh shejtanin qortoje veten tënde.
- 11** Gjithmonë siguroje veten tënde dhe kërko mbrojtje prej Zotit nga e keqja e cytësit të vesveseve.
- 12** Largohu nga shokët e këqij që të mos humbasësh nga rruga e drejtë pasi që je udhëzuar.
- 13** Metodologjia e jote le të jetë *ffjala e mirë*.
- 14** Mësoje veten të jesh mesatar, ruaju nga teprimi dhe shkapërderdhja.
- 15** Bëhu i singertë, se rrenacakët nuk kanë shpëtim.
- 16** Fol mirë dhe vepro mirë ashtu siç All-llahu të ka bërë mirë.

- 17** Ruaje dëgjimin tënd dhe shikimin tënd nga e keqja se All-llahu ka mundësi të ta merr (dëgjimin dhe shikimin).
- 18** Shfrytëzoje mendjen tënde dhe aftësitë tua me të cilat All-llahu të ka graduar, e mos i paralizo.
- 19** Në rrugë të All-llahut thirr me mençuri dhe polemizo në atë çka është më e mira.
- 20** Përfito aftësi në vete ashtu që të jesh në gjendje ta kuptosh dhe ta dallosh të mirën prej të keqes.
- 21** Ruaju lakmisë në vetvete, koprracisë, përtacisë, armiqve të All-llahut dhe njerëzve.
- 22** Mbizotëroje mendjen tënde dhe mos u bëj rob i epsheve dhe emocioneve tua.
- 23** Mos lejo që të mashtrohesh e tradhtohesh, andaj çdo lajm vërtetoje dhe asnjëherë mos thuaj se e kam parë për një send që se ke parë, ose të thuash kam dëgjuar atë çka nuk e ke dëgjuar, sepse All-llahu do të të merr në përgjegjësi për këtë.
- 24** Mos dëshiro të kesh gjithçka që kanë njerëzit, do të jesh më i pasuri i tyre. Pasuri e vërtetë është pasuria e shpirtit.
- 25** Ta dish, besnikët janë shumë të fuqishëm, e ti fuqinë tënde kërkoje në besnikëri.
- 26** Kërko ndihmë dhe mbështetje prej All-llahut sepse All-llahu është i mëshirshëm dhe i përkrah ata që kërkojnë ndihmë prej tij.
- 27** Bëhu me të dëgjueshmit dhe ata të cilët veprojnë dhe e pasojnë të mirën, atëherë All-llahu do të udhëzojë.
- 28** Kujtoje All-llahun i cili të ka udhëzuar në Islam, ta ka ndriçuar rrugën e drejtë dhe ta ka mbushur zemrën me dashuri ndaj All-llahut.
- 29** Përqendrohu dhe përmbaju në atë çka të ka urdhëruar All-llahu, sepse pas imanit vjen përmbajtja dhe përqendrimi (qëndrueshmëria).
- 30** Në çdo mbrëmje llogariti veprat tua, para se të të llogariten (para se të vdesësh).
- 31** Ruaju e mos e dëmto dhe mos e shkatërro veten me duart tua.

- 32|** Mos bëj gabime sepse gabimi të sjellë nënçmim dhe turpërim ndërsa besimtari gjithmonë është bujar, fisnik, i çmuar dhe i fuqishëm.
- 33|** Mos u bëj egoist, mos lakmo të kesh vetëm për vete. Natyrshmëri e muslimanit është që veten e le keq për t'u bë mirë tjerëve.
- 34|** Nëse mizëron veten (i bën padrejtësi vetes) kërko falje te All-llahu.
- 35|** Mos e tepro, dhe mos e ngarko veten më shumë se sa ke mundësi. Dera e shpresës gjithmonë është e hapur.
- 36|** Ke kujdes mos fsheh në vete çështje të cilat sjellin hidhërimin e All-llahut ndaj teje.
- 37|** Maturia është koka e ilaçit ndërsa teprimi është sëmundje.
- 38|** Shejtani është armik i të gjitha kohërave, mos i paso hapat e tij, por bëhu armik i tij.
- 39|** Mos e ngarko veten me atë çka nuk ke mundësi por me atë çka ke mundësi.
- 40|** Fitimi dhe vdekja janë vetëm në diturinë e All-llahut.
- 41|** All-llahu na sprovon neve me të mira ashtu siç sprovon me të këqija.
- 42|** Kush i frikësohet All-llahut dhe e ndalon veten nga epshet, vendbanim e ka xhenetin.
- 43|** Ai që i kalon kufijtë të cilat i ka caktuar All-llahu ai i ka bërë padrejtësi vetes së vet.

E dyta: Parimet për forcimin e Besimit

- 1|** Që nga fillimi përforcoje besimin në Zotin, shpejto pa masë në fitimin e kënaqësisë së Tij dhe mos lejo që diçka tjetër të të largoj nga Ai.
- 2|** Lutju vetëm Atij e askujt tjetër. Ai është i cili i ka krijuar qiejt dhe tokën.
- 3|** Ji me Atë, do të jetë me ty, sepse kush është me All-llahun, All-llahu është me të, e ruan dhe e mbron.
- 4|** Kujtoje All-llahun, Ai të kujton ty.
- 5|** Kërko falje prej Tij, Ai të falë.
- 6|** Falënderoj Atë për të mirat që t'i ka dhënë, haptazi e fshehtazi, me fjalë e me vepra, All-llahu do t'i shtoj të mirat e Tij.
- 7|** Lutu, do të pranohet lutja
- 8|** Pendohu do të pranohet pendimi.
- 9|** Adhuro vetëm All-llahun e askënd tjetër, ndërsa ndaj prindërve sillu mirë.
- 10|** Kërko prej All-llahut udhëzim dhe pajtim në veprimet tua, Ai do të udhëzoj.
- 11|** Kërko nga All-llahu i Lartëmadhëruar që Ai ta dojë imanin në ty, ta zbukuroj dhe ta përforcoj në zemrën tënde.
- 12|** Mbështetju All-llahut, të mjafton për gjithçka.
- 13|** Ta dish, All-llahu nuk është indiferent ndaj veprimeve tua, andaj ta dish se të përcjell pandërprerë ditë e natë.
- 14|** Frikësoju All-llahut, vepro çka të ka udhëzuar dhe largohu prej asaj çka ta ka ndaluar, atëherë Ai do të mësoj.
- 15|** Kush i frikësohet All-llahut, ai e nxjerr nga kurthet dhe ia zgjeron furnizimin.
- 16|** Veçojë dhe lartësoje All-llahun dhe lavdëroje shpesh dhe pandërprerë ashtu siç e meriton.

- 17]** Mos i dëgjo mëkatarët e as mos i përkrah të padrejtë.
- 18]** Jeta jote, veprimtaria jote, vendi dhe koha janë çështje në dorë të All-llahut dhe në dëshirën e Tij, andaj para të veprosh një punë thuaj: “Inshaa Allah”.
- 19]** Vështirësitë dhe fatkeqësitë nuk mund t’i largoj prej teje askush përpos All-llahut, andaj drejtoju Atij.
- 20]** Jeta jote le të jetë mes frikës (dënimit) dhe shpresës (shpërblimit), e po ashtu edhe garë në punë të mira.
- 21]** Shpresa në mëshirën e Zotit është punë e mirë.
- 22]** Çdo të mirë që e punon do ta gjesht te All-llahu. Nëse jep sadaka Zoti ta shumëfishon.
- 23]** Shtëpinë tënde stolise me kujtim në All-llahun, me falje të namazit dhe me qetësi për njerëzit.
- 24]** Mos u krekos me diturinë tënde sepse All-llahu është Ai i cili ta ka mësuar atë që nuk e ke ditur.
- 25]** Lutju Zotit që të ta shtoj diturinë në ty, të të bëj të dobishëm dhe të devotshëm.
- 26]** Dituria është dritë e edhe besimi është dritë. Lutu që këto dy të mira të kompletohen në ty.
- 27]** Nëse gabon ose harron menjëherë lutju Zotit që mos të të ndëshkoj.
- 28]** Falënderimi është shpirti i adhurimit, andaj falënderoje All-llahun vazhdimisht.
- 29]** Fol për të mirat dhe begatitë e All-llahut dhe insisto gjithmonë tek bashkëbiseduesit që të flasin për to, sepse All-llahu dëshiron që të shihen të mirat e Tij tek robërit e tij.
- 30]** Allahut nuk i përngjanë asgjë dhe askush nuk është i barabartë me të.
- 31]** Nuk duhet që të betohemi në All-llahun pa nevojë, por duhet që All-llahun ta çmojmë ashtu siç e meriton të çmohet.
- 32]** Nuk duhet që t’i fyejmë idhujt e tjerëve sepse kjo ndikon që tjerët të fyejnë Zotin tonë.

- 33]** Allahu është Ai i cili natën e bën ditë, për këtë arsye lutju Atij ditë e natë dhe merr këshillë dhe mësim prej saj.
- 34]** Feja e All-llahut ka rregulla dhe kufij dhe këto kufij nuk duhet t'i kalojmë.
- 35]** Ta dëgjosh (t'i nënshtrohesh, ta pasosh) pejgamberin në çdo gjë, do të thotë se e ke dëgjuar All-llahun.
- 36]** Jeta dhe vdekja janë në dorën e All-llahut, mos iu frikëso askujt pos All-llahut. Puno për botën tjetër që ta takosh All-llahun me vepra të mira.
- 37]** Allahu është shërues, përmbaju shkaqeve, shërohu dhe kërko prej All-llahut shërim.
- 38]** Nëse ke mundësi dhe të vjen rasti me iu bë padrejtësi njerëzve, kujtoje fuqinë e All-llahut ndaj teje.
- 39]** Nëse ke jetë të lumtur dhe begati prej All-llahut, kujdes dhe mos bëj mëkate, se mëkatet i largojnë begatitë nga ju.
- 40]** Bëhu harmonik në ekzistencën dhe në krijesat, sepse çdo krijesë e lartëson dhe e lavdëron All-llahun pandërprerë.
- 41]** Vështro qiellin si është krijuar, se si është zbukuruar me yje e planetë dhe mbushe zemrën me madhështinë e Krijuesit të Gjithëfuqishëm.
- 42]** Kujto Krijuesin i cili ta ka nënshtuar tokën, detin (ujin), ajrin dhe të gjitha gjallesat tjera.
- 43]** Ta dish se All-llahu na e ka nënshtuar (gjithçka) që ta shfrytëzojmë për mirësi dhe na e ka bërë tokën shtrojë (djep) për ta ndërtuar dhe për ta zhvilluar, e jo për ta shkatërruar.
- 44]** Përrjetoje dhe ndiej kënaqësi dhe nder në vete për të mirat që t'i ka dhënë All-llahu në pije dhe ushqim.
- 45]** Kur sheh diçka interesante dhe që të habitë, mos e humb mendjen por thuaj: Ma shaa Allah.
- 46]** Njihe All-llahun deri sa ta plotësosh imanin (pra, mos u mjafto me pak dije).

- 47]** Kur ta plotësosh imanin në All-llahun dhe të bindesh tërësisht thuj me bindje të plotë
- 48]** Islami është begati, begati e pakufishme të cilën ta ka dhënë All-llahu dhe të ka udhëzuar dhe ta ka plotësuar besimin.
- 49]** Pasuria, fëmijët, shëndeti, dituria, të gjitha këto janë begati, ajri është begati. Kujtoji të mirat e All-llahut të cilat janë të shumënumërta dhe të pakufishme.

E treta: Parimet për përmirësimin e gjendjes shoqërore

- 1|** Pas All-llahut, prindërit kanë përparësi që t'i duash dhe t'u bësh mirë më shumë se të tjerëve.
- 2|** Me prindërit sillu butësisht, folu fjalë të mira dhe lutu që të fitojnë mëshirën e All-llahut.
- 3|** Vepro që të fitosh kënaqësinë e prindërve dhe kërko që të t'i falin ty gabimet, sepse kënaqësia e tyre ndaj teje është kënaqësia e All-llahut.
- 4|** Babai e ka vendin më të ngritur në familje, me atë duhet konsultuar dhe prej atij leje duhet kërkuar.
- 5|** Prindin duhet dëgjuar, se duke e dëgjuar atë e ke dëgjuar All-llahun.
- 6|** Vëllai e forcon litarin e vëllait të tij dhe bëhen të fuqishëm.
- 7|** Vëllazëria ka të drejta dhe obligime. Dëshiro për vëllanë atë që e do për vete dhe lutu për vete dhe lutu për të.
- 8|** Vëllezërit duhet t'i planifikojnë çështjet së bashku dhe së bashku të planifikojnë për shpëtimin nga grackat e përgatitura.
- 9|** Dashuria, respekti dhe mëshira në mes të farefisit është prej urdhrave të All-llahut, andaj duhet t'i mbajmë dhe t'i forcojmë marrëdhëniet farefisnore.
- 10|** Ndaj të afërtit në familje ka obligime dhe detyra.
- 11|** Cilësi e muslimanit është që gjithmonë të flasë fjalë të mira.
- 12|** Shoqëria e besimit është shoqëri e vëllazërimit, shoqëri e pajtimit mes vëllezërve dhe shoqëri e devotshmërisë.
- 13|** Zemrat e besimtarëve duhet të jenë të pajisura me dashuri, duhet të jenë të pastra ndaj çdo zilie dhe urrejtje ndaj besimtarëve.
- 14|** Me fqinjët duhet të sillemi mirë, t'u flasim fjalë të mira pa marrë parasysh a kemi lidhje farefisnore apo jo.

- 15]** Me u sjellë mirë dhe me i fol fjalë të mira shokut të klasës, shokut të punës, shokut të udhëtimit.
- 16]** Udhëtarit i cili ka mbetur pa mjete financiare për t'u kthyer në vendlindje është obligim i yni që t'i ndihmojmë dhe t'i bëjmë mirë.
- 17]** Me jetimin mos u sjell ashpër.
- 18]** Lypësin mos e refuzo.
- 19]** Muslimani e ka të ndaluar që të cenojë të drejtën e muslimanit duke filluar prej vrasjes e çdo gjë tjetër.
- 20]** Muslimani e ka të ndaluar të prek në pasurinë e muslimanit, përpos asaj çka është e lejuar me shariat.
- 21]** Personaliteti i muslimanit është i nderuar pa marrë parasysh a është prezent apo jo, ai i cili prek nderin e tij është mëkatar.
- 22]** Shoqëria islame është shoqëri nderi, pastërtie, sinqeriteti dhe çiltërsie.
- 23]** Rregullat e dashurisë, respektit dhe simpatisë, Zoti i Madhëruar i ka caktuar në vendkuvendimet e muslimanëve.
- 24]** Urtësia është simbol i muslimanit. Selami është përshëndetja e tyre.
- 25]** Polemikët dhe diskutimi duhet të bëhen me dialogë të afërimit dhe mirëkuptimit.
- 26]** Edukata e pejgamberit është mostra e shkëlqyeshme e muslimanëve.
- 27]** Fjalët e buta janë simbole të çdo besimtari të devotshëm.
- 28]** Vajzës nuk i ka hije të flasë me fjalë provokuese pasi pa dashje mund t'i nxisë ata të cilët i kanë zemrat e sëmura, andaj gjithmonë le të flasë fjalë të mira dhe të matura.
- 29]** Të drejtat e njeriut duhet të çmohen, të vlerësohen dhe nuk duhet cenuar.
- 30]** Duhet t'i ndihmohet atij i cili meriton t'i ndihmohet, por nuk ka nevojë ta ndihmohet atë që nuk e meriton të ndihmohet.
- 31]** Muslimani, në shoqëri duhet të luaj rolin e ndërtuesit, zhvilluesit, e jo shkatërruesit.

- 32]** Çdo musliman duhet të veproj në ndërprerjen e luftës dhe duhet të angazhohet për paqe dhe pajtim.
- 33]** Paqja duhet ruajtur, ndërsa agresorin dhe kriminelin duhet ndalur.
- 34]** Drejtësia është simbol dhe specifikë e muslimanëve dhe kjo urdhërohet edhe në çështje të dënimeve (ligjore) sepse All-llahu nuk i do agresorët.
- 35]** Muslimani duhet ta zbuloj realitetin dhe të vërtetën dhe duhet t'i konfirmoj lajmet në mënyrë që të mos bie në gabim e pastaj të pendohet.
- 36]** Edukatë e muslimanit është që të largohet nga fjalët e pamoralshme dhe ofenduese dhe nga ajo çka nuk i përket atij.
- 37]** Besimtari nuk flet haptazi (as fshehtazi) për imoralitet dhe të këqija, sepse këtë All-llahu nuk e dëshiron.
- 38]** Besimtari nuk kuvendon për mëkat dhe armiqësi.
- 39]** Besimtari është i moralshëm, fisnik dhe përshëndetjen e kthen me të mirë.
- 40]** Gratë janë motrat e meshkujve, nuk e urrejnë njëri-tjetrin por ndihmohen mes vete.
- 41]** Ne duhet t'i vlerësojmë njerëzit me vlera dhe t'ua japim respektin e merituar.
- 42]** Me mendimtarët dhe të mençurit duhet konsultuar dhe duhet të marrim mësim prej tyre.
- 43]** Shit-blerja duhet të bazohet në besnikëri, drejtësi, sepse ato janë simbol i besimtarit.
- 44]** Butësia me njerëzit sjell deri te kryerja e detyrave. Mbajtja e sekretit ndihmon në kryerjen e detyrave. Zgjedhja e mirë është ushqimi më i mirë të cilin njeriu e posedon prej Krijuesit të gjithësisë.
- 45]** Bashkimi është fuqi ndërsa ndarja dobësi.
- 46]** Konfrontimi dhe kundërshtimi i ndërsjellë shpie në dështim dhe dobësi.
- 47]** Garimi në punë të mira është i pëlqyer.

- 48]** Të gjithë ne jemi një popull-Umet, ky unifikim është prej All-llahut dhe duhet ta ruajmë unitetin.
- 49]** Allahu është kujdestar i vijës tonë, Ai i di pengesat të cilat do t'na pengojnë.
- 50]** Të larguarit nga kriminelët është fitim.
- 51]** Muslimani nuk pranon padrejtësi prej tjetrit, por as nuk i bën padrejtësi vetes e as tjetrit.
- 52]** I riu musliman e ka obligim të profesionalizohet në shkencën e fikhut të fesë në mënyrë që ta këshilloj popullin e tij.
- 53]** Muslimani gjithmonë përqendrohet në drejtësi dhe e thotë të vërtetën edhe nëse është në dëm të vetvetes.
- 54]** All-llahu është i drejtë, e do të drejtën, e ne e kemi obligim që ta qesim të drejtën në shesh.
- 55]** Është obligim mbajtja e besës dhe kryerja e premtimeve. Obligim është ndërlidhja farefisnore. Toka duhet të zhvillohet.
- 56]** Ulja e shikimit dhe ruajtja e nderit është urdhër i All-llahut edhe për besimtarët edhe për besimtare.
- 57]** Shtëpitë janë të shenjta, ato duhet ruajtur. Për vizitat nëpër shtëpi ekzistojnë rregulla dhe norma të cilat janë edhe për vizitorin edhe për të vizituarin.
- 58]** Fëmijët kur të hyjnë në moshën e pjekurisë (bulug) le të kërkojnë leje.
- 59]** Elementi më i rrezikshëm në shoqëri është hipokrizia. I rrezikshëm është ai i cili kur flet rrenë, premton e nuk realizon, i besohet e tradhton, ai i cili e thotë atë çka nuk e ka në zemër por vetëm proklamohet.
- 60]** Mos kërko mbështetje dhe ndihmë prej armiqve të fesë dhe prej pabesimtarëve sepse ajo është cilësi e hipokritëve. Fuqia i takon All-llahut, të dërguarit të tij dhe besimtarëve.

SJELLJET TË CILAT KUR'ANI I KA MALLKUAR

- 1** Të ndaluarit (mosfalja) prej namazit.

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ ارْكَعُوا لَا يَرْكَعُونَ * وَيَلَّيْ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ

“Kur u thuhet atyre faleni ata nuk falen. Mjerë atë ditë për rrenacakët”

El-Murselat 48-49

- 2** Përtacia në namaz.

وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كُسَالَى يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا

“Dhe kur falen, falen me përtaci, proklamohen para njerëzve, ndërsa All-llahun nuk e përkujtojnë përpos pak”

En-Nisa 142

- 3** Neglizhenca në namaz.

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ * الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ

“Mjerë për ata që kur falen, ata në namazin e tyre janë tepër neglizhues”

El-Maunë 4-5

- 4** Proklamimi para njerëzve, ndërsa kur kanë nevojë për ndihma elementare pengojnë dhe refuzojnë.

الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ * وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ

“Ata të cilët proklamohen para njerëzve dhe pengojnë dhe refuzojnë që t'i ndihmojnë të tjerët për nevoja elementare”

El-Maunë 6-7

51 Nuk është mirë që të jepet sadaka e pasuria e pavlefshme dhe e keqe.

وَلَا تَيَمَّمُوا الْخَبِيثَ مِنْهُ تُنْفِقُونَ

“Dhe mos e merrni të keqen e pasurisë suaj dhe atë t’ua jepni tjerëve”

El-Bekare 267

61 Nuk është mirë t’i duash ata të cilët janë armiq të All-llahut dhe të dërguarit të tij e edhe nëse ata janë prindërit e tu.

لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ
أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ ۚ أُولَٰئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُم بِرُوحٍ مِّنْهُ ۖ
وَيُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۚ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ۚ
أُولَٰئِكَ حِزْبُ اللَّهِ ۚ أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Nuk mund të ketë popull të cilët besojnë në All-llahun dhe ditën e fundit dhe në të njëjtën kohë janë shokë, miq e dashamirë të atyre të cilët luftojnë dhe urrejnë All-llahun dhe të dërguarin e tij pa marrë parasysh a janë baballarët e tyre, apo fëmijët e tyre apo vëllezërit e tyre apo familja e tyre”

El-Muxhadele 22

71 Ikja nga fronti bëhet (lejohet) vetëm për ndonjë plan (tërheqje strategjike).

إِلَّا مُحَرِّفًا لِّقِتَالٍ أَوْ مُتَحَيِّرًا إِلَىٰ فِتْنَةٍ فَقَدْ بَاءَ بِعَضَبٍ مِّنَ اللَّهِ

“Përpos atij që shkon të sulmoj në krahun tjetër, ose për të plotësuar radhën e tjerëve si përforcim, ai i cili ia kthen shpinën atyre (luftëtarëve) ai veç e ka fituar hidhërimin e All-llahut”

El-Enfal 16

8| Thyerja e premtimit pas marrëveshjeve.

وَلَا تَنْفُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا

“Mos i thyeni premtimet pas marrëveshjes”

En-Nahl 91

9| Të marrurit e betimit të rrejshëm si mjet për të mashtruar njerëzit.

وَلَا تَتَّخِذُوا أَيْمَانَكُمْ دَخَالًا بَيْنَكُمْ فَتَرِلَّ قَدَمٌ بَعْدَ ثُبُوتِهَا وَتَذُوقُوا السُّوءَ بِمَا صَدَدْتُمْ عَنْ سَبِيلِ
اللَّهِ

“Mos i përdorni betimet tuaja për të mashtruar njëri-tjetrin, që të mos rrëshqisni jashtë rrugës së drejtë.”

En Nahl, 94

10| Koprracinë.

